

BIBLIOTEKA

E

BSHF. 32

A. 64.

SHËTIT

GJIROKASTËR

I VOGLI E MUND TE MADHIN

SOTIR
ANDONI

NOVELE



I mbaj mënd fort mirë ngjarjet e atyre ditëve të prillit, kur për herë të parë do më qepnin një palë rroba të reja. Deri atëhere m'i sajnin veshjet nga pantollonat e mbetura nga i ndjeri baba, por... më së fundi ato mbaruan. E mora ndër duar cohën larushe, që do pritej për veshjen time, dhe sytë m'u mbushën me lot. E që t'i fshihja lotët, e fërkova stofin pas fytyrës gjersa hunda më përkoi në një copë kartë. Çela sytë: një etiketë reklame! Në 'të dukej një vajzë me sy të hequr pak anash, sipër saj një qershi e lulëzuar e ndën 'to disa gërma që s'mund t'i lexoja.

— Mall i mirë — tha fqinji ynë, — edhe i lirë; që kur dolli Zhaponja e bëri batall Ingjilizë!

Unë nuk e vrava mëndjen të mësoj kush qe Ingjilizi e kush qe Zhaponja. Lashë cohën në arkë dhe shkova në shkollë. Dhe nuk di ç'na kishte hipur në kokë ne kala-

majve atyre ditëve; ndaheshim në shqip-tarë e turq e luftonim me shpata druri. Njëri bëhej Skënderbe, tjetri Sulltan; flamura sa të doje: sajonim si bori ca glyra me lëkurë shelgu, mburoja bënim ca saçe të vjetër, nga një herë edhe çantat e shkollës, dhe, o burra, bjeri t'i biem si Moskovi Turkut!

Më kujtohet se njëri nga pleqtë e fshatit tundte kryet me mospëlqim dhe rrihte tokën me bastunin e vet:

— Diç të keqe ndjejnë këta çocërit, janë si zogjtë përpara breshërit këta, s'është çudi të kemi luftë se edhe hëna, ka ca ditë, zu e del e kuqe gjak!

Kështu fliste plaku, por ai s'e dinte se, atyre ditëve, mësonjësi ynë Stefani, na mblidhte gjithë klasat në një vend dhe na fliste mbi trimëritë e Skënderbeut kundër sulltanëve të Turqisë.

Në klasë mësonjësi na shpjegonte, asaj dite, mësimin e historisë. Mbaj mend tek thoshte: «Mbretin e Ilirisë, Gencin, e kapën rob romakët, e mbrehnë në një karrrocë dhe e shëtisnin nëpër rrugët e Romës...

Papritur xhami i dritares nxori atë zhurmën që lëshon kur e qëllojnë. Një majë shkopi po rrihte aty:

— O Stefan! O mësues! Hape, hape!
Në rrugë ishte Mitreja, qiraxhiu i
fshatit, që sapo kthehej nga qyteti.

— Hë? — e pyeti mësuesi, — m'i so-
lle librat?

— Pse s'thua mandatë, Stefan? Man-
datë të solla. mandatë. ..

E tërë klasa u turr te dritarja. Mitres i
dridheshin buzët:

— Pllakosi Italia në Durrës, o Stefan;
po na shkel vëndin, po nisen vullnetarë
për luftë, dëgjon? Për luftë!

Kaq dinte Mitreja e kaq tha. U largua
kokëulur. N'atë çast harrova rrobat e reja,
vajzën me sytë anash, harrova historinë,
romakët sa dhe Gencin. Shoqja ime, Lena,
me të cilën rrija në një bangë, nisi të qajë.
Unë bëra ta qetoj, por ajo nuk pushonte.
Ajo dënesej e fshinte sytë me shami. Si
po dukej, ajo ishte ora e fundit me mëso-
njësin tonë Stefanin.

— Unë po largohem, — tha ai, — po
ikij për në luftë. I huaji që vjen po na
pushton Shqipërinë. Ju edhe jeni të vegjël,
por kur të rriteni do ta kuptoni më mirë
gjëmën që na ka mbytur sot. Lufta do të
jetë e gjatë dhe e ashpër. Të huajtë që vij-
në me dhunë, me dhunë do të ikin. Një

ditë unë do të kthehem dhe do t'ju gjej jo më nxënës, por luftëtarë... Tashti çohuni më këmbë, se do këndojmë himnin e flamurit tonë.


Nuk mbaj mënd të kem dëgjuar këngë të atillë. Ne këndonim dhe qanim njëherësh. Ishte një rast shumë i dhimbshëm dhe mësonjësi ynë këndonte bashkë me ne duke i pasur sytë të përlotur. Kur mbaroi kënga, unë guxova dhe pyeta mësonjësin:

— Po si do ta çlirojmë Shqipërinë, zoti mësoniës! Shqipëria është e vogël, Italia është e madhe...

— Do ta çlirojmë, Vasil. Kur është trim i vogli dhe ka të drejtën me vete, e mund të madhin. Këtë mbaje mënd dhe fute mirë në kokë. Ne do ta shporrim Italinë nga atdheu ynë, do ta mundim!

Mësonjësi na përshëndoshi të gjithëve një për një, pastaj se ku gjeti një mavzer të vjetër dhe me 'të u nis. Ai u nis, por unë mbeta me kokën ndër duar: si është e mundur — mendoja — si është e mundur që i vogli të mundë të madhin!

Nuk kaluan shumë ditë dhe një kollo-në me ushtarë të huaj hyri në fshatin tonë. Ishte një turmë e veshur me të gjelbërta e.



sapo ushtarët hoqën kaskat e hekurta, u shkëlqyen në diell kokat e ndriçme lyer me brilantinë. Me të qëndruar, ata u shpërndanë në livadhe e u përhapën tej e ndanë. U bë një zhurmë e trazirë që nuk e kisha dëgjuar gjer atëhere. Disa syresh vunë kazanët mbi zjarr, të tjerë ngulnin kunjat në tokë, kurse një shkurtabiq, me një mulli kafeje në dorë, hidhte një lloj valleje të çuditëshme. Të tjerë trokisnin gavetat, tiganët, pjatat. Turma qeshte, kurse ne, një grup çiliminjsh, rrinim hund e buzë bashkë. Nuk ka dëshpërim më të madh se sa kur këndon e këcen armiku. Por unë nuk mund të qëndroja më aty. E kapa për dore shoqen time Lenën dhe gati me zor e zvarisa tutje. Ajo nuk desh të vinte, por më erdhi në ndihmë nëna ime, e cila i foli edhe ajo: «Ikë që këtu, Lenë, hiq të them...» Dhe, si iu drejtua nënës së Lenës, vazhdoi: — Ç'i duhet kësaj bistrë këtu, u bë goxha çupë dhe po i ndritin faqet shejtanes!!!!

Mirë se shoqen time e hoqa tutje, por dëshpërimi më mbërthente gjithnjë. E keqja ime ishte te fjalët magjike: «I vogli e mund të madhin!» Duke pleqësuar punën në kokën time prej kalamani, guxova dhe

pyeta një plak të moçëm fort. Ishte ky një fqinji ynë, që rrinte gjithë ditën në diell, në oborrin e vet, mbasi qe zënë ulok që prej shumë vjetësh: «A është e mundur, xhaxhi Lipe, i thashë, a është e mundur që Shqipëria ta mundë Italinë, a është e mundur që i vogli të mundë të madhin?!».

Plaku fërkoj një copë herë gjunjët e tij të mpitë, qëroi gurmazin dhe qëlloi tokën me shkop:

— Po, biri im, po, i drejti dhe trimi e mund të madhin. Unë di një histori të vjetër, shumë të vjetër, aqë të moçme sa është bota. Dikur një mbret i keq, i quajtur Goliadh, në krye të ushtarëve të tij pushtoi tokën e Judenjve. Mbreti i Judesë e humbi toruan, ushtria e tij ishte gati të merrej nëpër këmbë, kur një djalosh i ri me emërin David i doli përpara mbretit Goliadh! Ky nisi të tallet me djaloshin shtatvogël, por Davidi nuk u përkul. Qiti një gur nga torba, e vendosi në prazhdën e vet prej kozine dhe viuuu... ja vërshëlleu Goliadhit mu në lule të ballit! Gjigandi ra i vdekur përtokë. Ushtria e tij, kur pa mbretin të shtrirë, i thirri vrapit; kështuqë Davidi i vogël, bashkë me ushtrinë e Judenjve, i vuri përpara hordhitë e Goliadhit të për-

mbysur. Kështu, biri im, i vogli trim, kur ka të drejtën me vete, e mund të madhin!»

— Po mirë, xhaxhi Lipe, por a mundet ta luftojmë ne Italinë me prazhda?

— Jo, jo, djali im, kohët ndryshuan. Tashti duhen armë zjarri. Duhet bomba, barut, pushkë, dhe mbi të gjitha duhet trimëri.

— Po trimërinë ku ta gjejmë?


— Ne, trimërinë e kemi në gjak!

— Po armët?

— Armët... armët... (plaku më vësh-troi në sy). Këto ne gjithnjë ja kemi rrëmbyer armikut.

Dhe në kokën time prej të vogli, fjalët e plakut zunë e po vendoseshin gjith' e më thellë.

Kaloi ca kohë dhe ushtarët e huaj nisën të mbështillnin tokën me tel me gjemba. Mirë se turat e telit i sillnin nga Italia, po hunjët e drunjtë? U vunë sopatën korieve tona. Ky ishte sulmi i tyre i parë kundër atdheut tim të vogël dhe këtu u mpreh armiqësia. Kodrat tona u mbushën me llogore, dhe llogoret shihnin nga lindja. Përrenjtë dhe grykat u mbushën me depo armësh, dhe armët vringëllinin. U hapën vrima e llagëme nën tokë dhe më dukej sikur toka



rënkonte nga pesha e armëve. Një oficer italian u mbante fjalë ushtarëve të tij: «Paret i kishim lireta dhe i bëmë lekë, nesër do t'i bëjmë dhrahme ¹⁾ pasnesër lira e kështu me radhë gjer në rupis ⁽²⁾ se ne do shkojmë gjer në Hundi, gjer te Moll' e Kuqe, se peshku i madh e ha të voglin!»

Kështu flisnin të huajtë dhe mua nisi mëndja të më punojë:

«Këta duan të pushtojnë botën e të grumbullojnë armë, po unë ç'bëj? A nuk tha mësonjësi im Stefani se do ta çlirojmë Shqipërinë? Po si do ta çlirojmë? Me se? Me gorica!» Davidi kishte prazhdë, por sot

1) Dhrahmë — njësi monetare e Greqisë.

2) Rupis — njësi monetare e Indisë.

nuk është më koha e prazhdës, se të tillë kisha edhe vetë. Po a ka djalë shqiptar që nuk do ta shkëmbente me qejf llastikën me një armë të hekurt?

Shtëpinë e kishim në fund të fshatit, e prapa kopështit ngrihej thikë përpjetë një shpellë e madhe. Faqja e saj e lagësht rrinte gjithnjë e veshur nga fletët e bërshlenit. Thellë në shkëmb qe një guvë dhe atje ishte strofka ime. Për atje më tregonte nëna:

— Në atë guvë, yt atë dhe gjyshi (ndjesë paçin) fshihnin dyfeqet në kohë të hajdutëve.

Po përse të mos fshihja edhe unë armë në kohë të italianëve? Mendoja: «A nuk janë hajdutë këta? Shqipërinë na e rrëmbyen, koriet na i vodhën...»


Fillova të bëj plane për të gjetur armë. «Stefani u nis për në luftë me armë, pra armë na duhen.»

Nisa të bredh natën përrenjve. Por armët ishin ndër arka e arkat nuk tundeshin nga vendi. Mezi rashë në një «madem» të mirë. Gjeta një depo me barut në qese prej linase si petulla, mbushur me ca si petëza të vogla në ngjyrën e tutkallit. Ai ishte baruti. Pastaj gjeta fitil për dinamit, fishekë



në krehërë, bomba të kuqe, pushkë të gjata, gjeta edhe ca farë topuzësh prej hekuri. Edhe të tillë zvarisa në kështjellën time. Armët i kuptoja përse vlenin, po për topuzet nuk kuptoja gjë. Përse duheshin topuzet? Nuk gjeta dot përgjegje gjer të nesërmen kur pashë italianët që shkruanin një parullë të madhe, në murin e anës së përparshme të shkollës: «Spezzeremo i reni ai greci». Dikush ma përktheu: «Do t'ua thyejmë brinjët grekëve!» (Ç'të thyer ua bënë se!).

Truri zu më punonte si ujët e kusisë kur lloçoçit. Hyja në guvë dhe mendoja: Me Skënderbenë, Shqipëria e vogël e munda Turqinë e madhe. Skënderbeu ka pasur kështjellë, por edhe unë kam; barut sa të duash; pushkë pasë copë. Po top? Kisha dëgjuar se bëhej një i tillë edhe prej gorricë, Prandaj plasa gjersa zvarisa në kështjellë një trung të tillë, që e ngrita mbi dy këmbëza me «grykë» nga hyrja. Kur arri ta gjer atje, m'u çel dëshira për një «lojë luftarake». Isha i këtij mendimi, sepse italianët javë për javë, kurdisnin të tilla dhe kur ktheheshin ushtarët nga malet, nuk kishin ndër këmbë veçse mbeturina dollakësh. Diku anës së lumit midis tumbës së



shelgjeve, tek mensa e oficerëve, ushtarët po ndërtonin një farë kulle prej guri, kështu e kuptova unë.

«Ja, mendova, këta po ngrenë kështjellë këtu kundrejt kështjellës sime, ashtu si e ngritën turqit në Valm kundër kështjellës së Krujës».

Nuk u thellova shumë në plane e parashikime, se kisha dëgjuar se po u mendove shumë në punë lufte, je frikacak. Natën, mbusha dy torba me qese baruti, një rrodhan fitili në krahë, shkrepse në xhep dhe në mesnatë dolla nga shtëpia. Errësi e an' e mb'anë. Patrullat shëtisnin nëpër fshat, mushkat hingëllinin. Nga lagjeja lart shihej një dritë e vogël në central, telefonisti i huaj çirrej e shahej kushedi me kë. Ju afrova kullës së armikut! Vinte era llaç. Nër këmbë traversa e drasa për çatinë. Në mes të «kullës» një farë grope me kanal. Hë, hë? Kjo nuk qënkej kullë. E paskëshin për... (Ju e kuptoni se çfarë ishte). Pa shiko ku paskan gjetur, thashë, të ngrenë nevojto-re pipinot e djallit, mu përpara shtëpisë sime, mu karshi kullës sime! Dale pa të shihni!

Gropëzën në mes e rrafshova me qeset prej linace, futa kreun e fitilit në 'të, dhe

dolla bashkë me fillin. Kur bëra njëzet çape më tutje, fundi i fitilit më krojti dorën. U shtriva barkas. Gati! Në sulm! I vogli kundër të madhit! Një gjuhëzë e kuqe dhe e vogël si flakë kandili, një fësh fësh xixash pas fitilit, vetë ngula kokën përdhe. Një rropamë gjëmoi gjer në qiell, fshati u lëkund me gjithsejt, flaka u ngrit lart, tymi kundërmoi.

— Greçi, porko madona! (1) thirrën italianët.

Rrëmujë dhe ulërime nëpër fshat. Xham nuk mbet më këmbë. Si u gjenda aqë shpejt ndën levenxën time s'e kam marrë vesh as atëhere as tashti. Nënës më duket se diçka i ra erë, por nga frika nuk e hapi gojën të më fliste. Nuk fjeta gjithë natën e dëgjoja zhurmat e të huajve përjashta që shanin e mallëkonin. Në mëngjes më shponin sytë e dolla jashtë për sehir. Por nëna më qëndroi:

— Italianët po kolendritin (2), derë më derë, kërkojnë kush ka barut dhe armë.

Njeri gju m'u drodh e nuk di përse bëra tërheqjen e parë. U fsheha në kështjellën time. Nuk më besohej se mund t'i vinte në mëndje njeriut për të kontrolluar

1) Grekët, ta marrë djalli.

2) Kolendrit — kontrolloj

nën driza e ferra. Por mëndjen e kisha rrëmujë e nisën të më dridhen të dy gjunjët. Sytë më shkisinin si prej vëngëroshi e zëmbra më hidhej përpjetë. Por sidoqoftë unë duhej të isha gati edhe sikur ata të qaseshin tek unë. Shkova në kamaren e armëve dhe mora turën me spango. Pastaj me të lidha kokën e kosheres me bletë, që mbanim buzë oborrit prapa gardhit e, duke marrë pas fillin e spangos, shkova u struka në guvën time. Nuk di sa kohë kaloi kur në oborrin tonë u dukën të huajt. I pashë një për një të gjithë ata bukuroshë me flokë të lëpirë si nga macja, krehur e pispillosur si për në dasmë, ca me xhufka, ca me pendë, ca me pallto, ca me pelerina. Krisën shkallët e shtëpis, u tundën magjet dhe hambari, krisën dyert e dyshemetë. Njëri qiti kryet lart në baxhë, dollën përsëri n'oborr, dikush futi kryet te furra e zgjati hundët nga unë. Në atë çast m'u kujtua mësimi i historisë: «mbretin Genc e kapën gjallë në kështjellën e tij këtu e dymijë vjet më parë, e muarën rob, e mbrehnë në karrocë dhe e shëtisnin rrugëve të Romës».

— O Genc, kur ardhën e të kapën italianët ty, a kishe në kështjellë koshere me bletë? Sigurisht që nuk ke pasur. Por unë,

o stërgjyshi im i vjetër, unë kam. Dhe unë do marr hakë edhe për ty!

Filli i spangos m'u drodh në dorë dhe e tërhoqa fort. Koshi me bletë ra nga pezuli përmbys. U duk sikur kosherja roiti. Bletët u lëshuan si grera të egërsuara. Më nuk pashë se çfarë u bë. M'u desh të mbuloj kokën me thes, sepse edhe drejt meje u lëshuan një tufë bletësh. Dhe asaj pasditeje, çdo i huaj që i kishte faqet të buhavitura, veshët si opingë, sytë sa një thierzë dhe buzët sa një patllixhan, kishte qënë për kontroll në shtëpinë time. Për djall, kur takova nënën te shkalia, nuk kuptova dot në qante a qeshte. Sytë mezi i dukeshin, e ndën qafë i varej një gushë. Ç't'i bësh? Edhe atë e patën thumbuar bletët. Mirë e thotë populli një fjalë: nga i ligu e pëson edhe i miri.

* * *

Më vonë ardnë një vjeshtë e keqe me shi, me baltë dhe erë të ftohtë. Fletët e drurëve ranë shpejt, pylli u zvesh e krisi lufta. Italianët donin të pushtonin Greqinë.

I mbaj mënd fort mirë ushtarët e mër-zitur e të pangrënë me kuverta mbi kokë, tek dridheshin nga e ftohta. Djem nga Sigelia veshur hollë, me dyqind gram bukë

në ditë, nën komandën e ndonjë kapteri, zvariseshin nëpër baltë, nëpër tymin e luftës, në vend të huaj. Nuk e fshihnin mërzinë e tyre. Por kishte edhe të tjerë, më fort ata me këmisha të zeza, që çirreshin si djaj duke brohoritur për Duçen, këcenin rrugëve, dhe mbanin fjalime si palaço të kurdisur me zemberek.

Topat nisën të qëllojnë, të tjerë u përgjigjeshin që m'at'anë, dhe unë e humba toruan.

«Po Shqipërinë kur do ta çlirojmë? Stefani ç'u bë? Ku shkoi ai e ku ndodhet? A e di mësonjësi im se unë mblodha armë që kërkonte ai?», mendoja.

Një ditë, lufta u bë më e rreptë. Grekët sulmuan dhe italianët ua mbathën këmbëve. Te shtëpia jonë (me që ishim prapa shkëmbit) ardhën e u strukën edhe fqinjët. Ardhën edhe dy oficerë italianë, nga ata që mbanin kyçet e depove.

— Zotërinj, u foli fqinji, po hallit tim si i bëhet? Më muart hua bukën e gojës, e zbrazët hambarin tim, po tashti?

— Mos ki frikë, — u përgjegjën ata, — ne vërtet do ikim, por prapë «torneremo» e vinçeremo.

Me këto fjalë «**torneremo e vinçeremo**» ata thoshin :«do kthehemi e do fitojmë».

— Mirë, mirë, — ja ktheu fqinji, — mirë se juve «torneremo e vinçeremo», por unë çfarë «**manxheremo**»? (Me fjalën **manxheremo** fqinji donte të thoshte: — çfarë do ha unë?)

Atëhere oficerët ja pritën:

— Hë për hë, merr makaronat që kanë mbetur në mensë, por ne përsëri «**torneremo e vinçeremo**»!

Fqinji vijoi të flasë edhe për fushën me misër që na e prishi ushtria, për shpezët e gjënë e gjallë, që na i hëngrën, për korijet që na i prenë... Por ata gjithë drugën e tyre: «**terneremo, vinçeremo**»!

Afër shtëpisë sonë ishte spitali ushtarak. Aqë të plagosur hynë e duallën atje sa bandat e ngjyera me gjak ishin hedhur si stivë në oborr. Kurrë nuk do ta harroj erën e rëndë të gjakut të njeriut dhe erën e rëndë të barutit që vret njerinë.


Më darkë herë fqinji u lëshua në mensën e italianëve për makarona, kurse fshati i tërë për hesape të tjera. Po unë mos duhej të rrija duarkryq? Ç'do të thoshte mësuesi im Stefani në këtë rast? Sikur të qe ai këtu, do rendëte për thasë me maka-

rona apo për armë? Ai edhe një top mund të hiqte më nj'anë. Nuk ishte e vështirë mbledhja e armëve, mjafton të zgjatje dorën, se pushkët e hedhura shtriheshin nëpër rrugë. I kishin hedhur ushtarët e mbretëris së madhe në luftë kundër ushtarëve të mbretërisë më të vogël. Kështu që gjer afër mesnatës, kështjella ime rënkonte nga pesha e armëve. Në mes heshtjes gënjeshtare të luftës, krisën sharapnelët mbi fshat. Sërish u strukëm në shtëpi; veç fqinji i makaronave s'desh t'ja dijë, se ndryshe i mbeteshin fëmija pa bukë. Kishte hallin e tij edhe ai. Na thoshte:

— Po ardhën grekët e më gjetën hambarët me makarona, m'i muar të gjitha.

Fqinji çeli mullirin e madh të fshatit aty pranë, i ngriti gurin një pykë më lart dhe e lëshoi në sulm. Makaronat rridhnin nëpër pot e dumanj i miellit ngrihej lart sikur bluhej urof.

Përsëri ra heshtja e çuditëshme që bie nga një herë në mes të luftës. Nëpër mjer-gullën dhe errësirën e natës qimtonte një llohë e ngadalshme duke rrahur fletët e thata të fasuleve. Atëhere dukej sikur njerëz, të fshehur kopshteve, përshpërisnin e zvariseshin.



U ngjita në odën lart e nga ballkoni hodha sytë tej. Nuk dukej asgjë. Papritur, veshi im diçka dëgjoi. Në çesmen kundrejt nesh rrjedha e ujit trazohej. Pra dikush mbushte ujë atje. Pastaj një trokëllimë te neqeje, dy, tri, disa të tjera. Fryjti era e shaku reja. Ashtu pashë, aqë sa mund të shohë një djalë i ri nëpër dritën e mekur të yjve. Një njeri, i ngarkuar me pagure, mbushte ujë. M'u duk sikur zëri im që i një tjetri:

— Hej, kush je ti?

Ndjeva se disa pagure u përpoqën pas gurësh. Një hie tjetër u shkëput nga kollo-na e kroit dhe u bënë dy. Ata folën midis tyre dhe unë mund të betohesha se nuk ishin as vendas as italianë.

Pastaj një zë foli shqip:

— Hape portën, djal-o!

Kur zbrita në sobë e thashë se dy grekë janë te porta, fqinjët u ngritën në këmbë, kurse nëna uli fitilin e kandiles. Unë i hoqa llozin portës. E mbaj mend fort mirë se ç'më panë sytë: rroba kaqi, supe ngarkuar me pagure, dollakë me baltë të kuqe, kapota të qullura fort, fytyra me mjekër, pallaska mbi gjoks.

— Jemi ushtarë të huaj, vijnë si miq!

Prej tyre muarëm vesh se ushtria e grekëve kishte hyrë në fshat. Njëri syresh dinte shqip e fliste rrallë me një zë të shtruar, duke i menduar fjalët një nga një. Shihte kandilen tonë me një vështrim të tillë sikur don të zbulonte se kush e kishte sajuar. Duke iu qasur, unë e pyeta:

— Po si ndodhi, o mik, që i mundët italianët?

Ai më përkëdheli kryet e ma ktheu:

— Kur është trim i vogli e ka të drejtë, e mund të madhin!

Ja, kështu, fare papritur ai grek më ngjau me Stefanin, mësonjësin tim. Rrija e çuditesha. «Ky grek që e quajnë Thanasi vërtet se është mësues po është më i shkurtër, Stefani është i gjatë; ky Thanasi është ezmer, Stefani vjen i bardhë; ky ka fytyrë të gjërë, Stefani të hequr. Po pse më ngjet me Stefanin? Çudi! Kur ikën dy grekët, nuk e di pse, harruan një bombë. Kur e pashë, ata ishin ende në oborr, po nuk u thirra t'ua jepja. Aty për aty vendosa ta mbaja duke menduar se unë nuk mblihdja hekura për qejf, as pare për bukë, as rripa për prazhdë, hajdut nuk isha. Unë djaloshi, me prenka në fytyrë e me hundë

si shkabë, mblidhja armë e bomba për atdheun tim të robëruar.

* * *

Kur u gdhi, fshati që mbushur plot e përplot me ushtarë grekë. Tjetër zhurmë u ngrit rrugëve, tjetër veshje që ajo që shihja, këngë të tjera, fjalë të tjera. Aq njerëz dhe ngjarje pashë asaj dite sa në mbrëmje më dhimbte koka dhe rashë të fle që me pulat. Por sado i fjetur, koka ime prej të vogli ishte lidhur fort me ndodhitë e ditës, pa më dollën në ëndër gjith sa kisha parë e dëgjuar. Kështu ëndëritesha me kuaj të vegjël si gomerë, mbi samarët e tyre ngulja bisqe dushku, pastaj dëgjoja këngë nga të ishujve dhe ëndërat e mia kalonin shpejt e shpejt ngatërruar e gërshtuar nga pamje e thirrje të papara ndonjë herë. Kur u zgjova të nesërmen, mësova se ushtari Thanas ishte vendosur përgjegjës i depove në një shtëpi aty pranë. Dhe unë që i hapa portën i pari, unë që i fola i pari, unë që u miqësova me 'të i pari dhe, më në fund, unë që ja mora bombën i pari... unë isha miku i tij i zemrës. Fillova t'i vij rrotull

e t'i bëhem ndihmës. Gjithë punët që i kryeja atij nuk i bëja për bomba të kuqe prej teneqeje, nuk i bëja për pushkë të gjata italiane, as edhe për topuzë me të cilët «do t'u thyheshin brinjët grekëve». Jo, jo! Tashti gjithçka e bëja për bomba greku me samar e për ndonjë maliher që i shkiste llozi sikur futej në gjalpë.

Nuk dija si ta bindja Thanasin që të më jepte armë nga të tijat. Mbaja mend se vitin e shkuar nëna i kishte dhënë kryeplakut një kokosh e ai na shpëtoi nga taksa e xhelepit. Pra iu luta nënës të therrim manarin tim e të ftonim Thanasin për drekë.

— Ai na dha miell kur nuk kishim bukë, por më tej, si mik që e kam, kushe-di ç'do na japël...

Vajti dashuli im me brirët e kthyer si turjelë. E therëm dhe e poqëm. Por unë nuk dija si bëhen këto punë, nuk kisha haber si thuhen kërkesat pa i rashë më të prerë:

— Dua një maliher greku, o Thanas!

Ai vështroi nënën time mu në sy, pastaj ngriti supet dhe e ktheu kuvendin në shaka:

— Jo, jo, se ku ta dish, ngrihesh ti


ndonjë ditë e na shpall luftë, na vë përpara ushtrinë pa na mbyll në Akropol!

Si më shkoi bosh çapi i parë, rraha patozin me këmbë: «Po të mendohesh shumë je frikaman...» thashë me vete.

Dhe kështu një ditë hyra tinëz në depone e grekëve; dhe ndërsa isha kërrusur e futja bomba në xhep, fare papritur hyri Thanasi, në depo e (si thotë fjala) më kapi me presh në duar e me thes aty pranë! Unë ngriva në vend e s'kisha nga t'ja mba-ja, se mbeta si miu në dhokan. Por sa i mirë ishte Thanasi! Sikur të më zinte vërtet me presh nga ata që kanë mustaqe të bardha, Thanasi do të m'i sillte gjer në shtëpi dhe mbi kurrizin e vet. Por në këtë rast ai e mori punën me të qeshur e më uli mbi një arkë armësh kundrejt vetes. Më foli:

— Dëgjo, Vasili im, t'i lemë shakatë: Ty s'ka pse të të duhen armët. Unë do të të jap diçka tjetër që do kënaqesh. Na, merr nja dy a tre nga këta qirinjtë e mëdhenj e me ta bëj kashtare...

Vështrova ata farë qirinjsi. Ishin të gjatë e të trashë sa një hu gardhi. Qenë sajuar me fije kërpi përzjerë me dyllë



blete. Kur mbeta i habitur para tyre, Thanasi më shpjegoi:

— Këta qirinj përdoren në luftën mbrojtëse. Kur sulmon armiku, ngulim qirinjtë në tokë, i ndezim e, nëqoftëse armiku përparon, duket që prej së largu. Janë qirinj për mbrojtje si të thashë...

— Unë nuk dua qirinj për mbrojtje, jo, — ja ktheva hundë e buzë bashkë, — unë dua armë për sulm!

— Po ç'djall i do gjithë këto hekura që vrasin njerëz?

— I dua, o Thanas, i dua... ashtu... si të të them. Disa kanë qejf të mbledhin pulla, disa mbledhin thana e lajthi, disa haliçë,.. kurse unë kam qejf për dyfek, prandaj të lutem ma lerë!

Thanasi qeshi me një farë dëshpërimi të mbledhur në rrudhat e ballit sikur desh të gjykojë egërsinë time. Por unë i lutesha gjithnjë:

— Lerma, o Thanas, lerma.

Këtu nuk munda t'i mbaja lotët. Dënesat më mbytën në grykë menjëherë, sepse unë po qaja përbrenda, që në çastin që më kapën aty brenda.

— Po unë i dua armët për Stefanin, o

Thanas, për shokun tënd Stefanin, për atdheun tim.

Greku u praps e më vështroi sikur unë të isha në fund të arkave me gjyle. Më shikonte sikur s'më kishte parë kurrë ndonjë herë. U ngrit më këmbë i shqetësuar dhe sytë nuk m'i ndante.

— Kush është ky atdheu yt?

— Shqipëria, o Thanas!

— Po ky Stefani cilij është?

— Ai është mësonjës si ti, shok me ty; kaq kohë u bë që ka shkuar në luftë e unë s'di ku ndodhet. Ti duhet ta njohësh Stefanin...

— Jo, nuk e njoh.

— Po ai ngjet shumë me ty.

— Po ç'ka të bëjë?

— Stefani flet si ti, gjykon si ti, dhe ka një zakon të keq si ti, nuk shkon kurrë në kishë!

— Aaa!

Greku u kërrus edhe më nga unë. Kapi tëmthat me mollzat e duarve, e bërrylet i nguli mbi tryezë. Sytë i lëshonin xixa dhe një tufë floku i varej mbi ballë si një drapër i vogël.

— Shumë bukur, kapedani im, shumë

bukur, tashti e njoh Stefanin, po, po e njoh.

— Shiko sa mirë.

— Dhe Stefani të ka ngarkuar të mbledhësh armë?

Tunda kryet në shenjë pohimi. Dhe atë çast u bëra gati të tregoj të fshehtën time për strofkën e mbushur me armë. Ja që kur të kapin në faj diçka të papritur kërkon të çfaqësh. Këtë dobësi e kam edhe vetë. Ngrita kryet dhe bëra të çel gojën, por u mbajta një çast. Përpara meje, në murin e depos, ishte varur një pikturë greke me ngjyra. Në të dukej një italian i shëmtuar me dorën vënë si strehë mbi veshin e vet të stërmadh, që përgjonte. Ndën pikturën shkruhej gërqisht: **Siopi**. Që desh të thoshte: heshtje. Në çast m'u kujtua se edhe italia-nët shkruanin nëpër mure: «**Silenzio, il nemico ti ascolta**» që don të thoshte: Heshtje, armiku të dëgjon». Mendova një çast: Shqipëria ime e varfër nuk ka piktura të tilla, por me gjith' këtë duhet heshtur. U gëlltita dhe ula kryet.

—... këtu fillova, o Thanasi, po u pa puna, ti hëngre dashin tim, unë do lëpij hellin tënd.

Atëhere Thanasi im i mirë m'u qas,

më përfshiu për qafe e më puthi si të më
kish djalin e vet.

— Ti je prej race luftëtarësh, Vasil, i
di ti trimëritë e Skënderbeut?

Këtu mora kurajë dhe qita gjoksin për-
para:

— I di, po, unë di edhe vjershën e tij.

— Pa ma thuaj.

Ngrita kryet edhe më, lëshova në çast
njeren anë të thesit që më kish mbetur në
dorën e majtë dhe ngrita zërin:

Lufton luftën dhe fiton,
Mbreti Vladislav gjëmon...
Djeg si ferr, si vdekje pret,
Ditën e Rrushajavet

.. .. .

Pa mbaruar këtë fjalë
Një hanxhar i rëndë ra,
Kur s'ish afër asnjë tjetër...
Dhe qatipi po përmbysset,
Si një gur që rrokulliset
Në liqen të zi dhe shket
Tatëpjetë dhe humbet...

— Të lumtë, Vasil, të lumtë po për ka-
pedan Kanarin ke dëgjuar?

— Jo.

— Po për Bubulinën?

— Jo.

— Po për Kozma Turkngrënësin. për Boçarin e madh?

— Jo. Jo. Jo. Po ç'janë këta?

— Këta kanë qënë kapëdanë të mëdhenj nga raca jote. Se ju jeni racë trimash dhe ti kur të rritesh me këtë hundë prej shkabe, me këtë kokë kryeneçe, me këta sy prej sqifteri, do t'i dalësh zot atdheut tënd!

Pa dale, mendova, pa dale ta pyes Thanasin për punën e të voglit dhe të të madhit, pa dale...

— Nuk më thua, Thanas, si është e mundur t'i dal unë zot Shqipërisë; atdheu im është i vogël, Italia është e madhe.

— Po nuk shikon se ç'bëhet kësaj kohe? Edhe Greqia e vogël është, por e mundi Italinë e madhe. Ti ta dish prej meje, kur i vogli është trim dhe ka të drejtë; e mund më të madhin, dëgjon? Tashti eja se këtë çështjen e armëve që kërkon, do ta shohim përsëri.

* * *

Një mbrëmjeje, ngjau në fshat diçka e papritur. Ardhën dy oficerë grekë dhe kërkuan të mblidhen burrat e katundit në sallën e shkollës. Më shtynte kureshtja për

çka do flitej atje dhe kur u mbashën bangat tona plot e përplot, u struka në një qoshe dhe mbajta vesh. Të huajt flisnin në gjuhën e tyre dhe s'mund t'i kuptonim, prandaj një fshatar i ynë përkthente:

Greku e hapi fjalën e tij me disa mburrje të zakonshme, pastaj kur nuk pandehte njeri, na tha troç:

— Tokat, që ndën Shkumbin e poshtë, i takojnë Greqisë në jetë të jetëve.

Disa nga burrat ulën kokat, disa u kollitën, disa shpuan njëri tjetrin, kurse greku akoma s'kishte pushuar:

— Ne kemi ardhur sonde këtu, do shkruajmë një kartë e të gjithë do vini firmat për të vërtetuar se ky fshat është tokë e grekut dhe ky fshat i bukur shpallet i lirë ndën flamurin grek...

Oficeri desh të fliste akoma kur ardhi e ja preu fjalën Mitre Qiraxhiu:

— Përse i hyni një pune kaq të pësh-tirë, zoti oficer? Në jemi shqiptarë, se kështu na ka mësuar nëna që në djep, për-se?

Greku së pari nuk u ngut, qeshte me ca dhëmbë të përdalë e të verdhë nga duhani, kurse rrudhat anës së syve i duke-shin si krimba. I foli Mitres:

— Nuk më thua zotrote, ç'punë bën?

— Jam qiraxhi — ja ktheu bashkë-fshatari.

— Shumë bukur, zoti Mitre, të japim ty një kalë të mirë nga të italianëve ta kesh për zanatin tënd dhe mos na bëj llafe shumë...

Po Mitreja nuk u ul. U xhindos dhe mori zjarr:

— Unë nuk jam mushkë, e as gomar, se vetëm këtyre u japin nga një torbë me elb, që pastaj t'u hedhin kapistallin... Dëgjo, o zoti grek, dëgjo fjalën e një plaku shqiptar e pastaj po deshe thuaj se s'kam të drejtë. Ne jemi fqinjë, ose gjitonë, quajje si të duash. Mos mbillni një hasmëri të tillë se nuk bën. Italinë do ta përzëmë, do ikë tej detit, por ne do qëndrojmë këtu pran' e pranë në jetë të jetëve. Mosni me zhabë në bark, mosni me të pushtuar truallin e të tjerëve..

Të dy oficerët muarën zjarr, deshën ta kapin Mitren, po ky u hodh nga dritarja dhe nëpër errësirën u zhduk. Mbledhja u shpërnda, por grekët rrahën gjoksin dhe u mburrën faqe fshatit:

— Ne na takon ky vend dhe do ta marrim, se peshku i madh e ha të voglin.

Në errësirën e natës, unë kisha ngri-
tur lart gishtin e madh si të desha t'i them:
Hipë këtu të shikosh Stambollin.

Që asaj nate shkova drejt e te Thanasi.
Fjalët e oficerëve grekë më përvëluan.

— Po përse, o Thanas, ai oficeri tha
se peshku i madh e ha të voglin?

Thanasi mblodhi buzët, rrahu tryezën
me grusht e ma ktheu:

— Tha kështu, djali im, sepse ai ofi-
ceri është peshkaqen. Por ti mos u tund,
mbaj mend çfarë të ka thënë Stefani, më-
sonjësi yt: I vogli trim e mund të madhin!

Nga këto që dëgjoja më hipi në kokë
kureshtja. Mendoja ditë e natë: «A mun-
det me të vërtetë që i vogli, me ndihmën
e armëve, ta mundë më të madhin, ta
mposhtë, ta verë përpara? A mundet, fjala
vjen, Shqipëria të verë përpara Italinë?
Për këtë (sikurse thoshte Thanasi) duhej
edhe guxim edhe trimëri edhe drejtësi;
bukuri, edhe këto mund t'i kishim. Domo-
do, kur të pushtojnë shtëpinë, trimërohesh.
Po vallë si ndodh vënëja përpara e armi-
kut! Se, në fund të fundit, i vogli është i
vogël, i madhi i madh!»

M'u paraqit një rast i vyer. Asaj kohe
vija në mal për dru. Shkoja herët në mën-

gjes lart në mal, rrëzoja dy tre dushqe në korien tonë, i shkurtoja në kotuqe e pastaj i ngarkoja në gomar. Por një ditë, Çomë Samarxhiu, burrë azgën me një barrë mustaqe, vjen e më kërcënohet në shtëpi:

— Dëgjon? Ke prerë dru në hisen time në koriet, ta dish, po të zura edhe një herë, do të të var në një degë lisi!

I dhashë të kuptojë se unë pata prerë dru vetëm në pjesën tonë, i tregova në sy të nënës sime se sinori i kishte shenjat të qarta: te Përroi, te Çuka, te Gorrica me zgërbonjë... Por Çomeja s'desh të dëgjojë dhe m'u mbush mëndja top se atij i qe hapur oreksi të na zhvaste ndonjë pash vend nga korieja jonë.

— Po të zura do të të var!

— Ashtu? — ja ktheva unë, — dale se e shohim.

«Ja rasti i provës, mendova vetë. Pata shohim këtë Çomen trim e katallan, që këtu në fshat gati përpin retë.»

Shkova në «kështjellën» time. Atje mbaja dy lloje bombash dore: bomba greke për mbrojtje, bomba italiane për sulm. Këto merita të armëve nuk i kisha caktuar unë. Si tregonin punët asaj kohe, llojet e armëve i shënonin ata që bënin politikën, Pra, futa në xhep një bombë të kuqe nga



ato të sulmit, vura gomarë përpara dhe, ush, për korie. Kur mbrijta në vend, lidha kapistallin e kafshës te një trung e nisa të qëlloj me sopatë dushqet gjithë në pjesën tonë. Sakaven e kisha mprehur pun'e madhe, krahët i ndjeja të fortë dhe puna më shkonte bukur e mirë. Pas pak dëgjoj të thirrura dhe kanosje përtej. Hipa në majën e gorricës me zgërbonjë dhe hodha sytë nga luadhi i Peshës: Çome Samarxhiu, me një hu në dorë, po ngjitej këtej duke vrapuar. Kapërxeu vahun, kaloi përruan e po ngjitej nga isha vetë. Kur e pashë në fund të kories nëpër trungjet e lisave tërë sulm e inat m'u duk se e humba davanë. Dhe nuk ishte e keqja te barra e druve! Llogaria ime bëhej gjetiu: i vogli kundër të madhit. Ja, ky mendim loste valle në kokën time.

I hoqa lapëzën bombës së lehtë prej alumini dhe bërtita:

— Dashke t'i rrëmbesh korien jetimit pa baba, hë! qen o qen! afrohu pa të shikosh, sa para të bën lëkura!...

Për ta vrarë Çomen nuk kisha ndën mënd kurrsesi, prandaj u shtrita dhe e flakërita bombën brenda në zgërbonjën e gorricës. Kokën nuk e ngula përtoke, se bomba, si ju thashë, ra brenda në zgërbo-

një, por që pas një dushku shihja Çomen kapadai. Te vrojtimi që gjithë puna: ç'do bënte i madhi kundër të voglit!

Gjëmimi i parë ushtoi në pyll, e rrëmbëu jehona luginë më luginë e grykë më grykë, por fill pastaj m'u bë se një gjëmim tjetër po rrokullisej tatëpjetë përroit. Më dukej sikur një gjym i shpuar rrokullisej nëpër gurë... Ishin lebetitë e Çome Samarxhiut që, duke ikur ku sytë këmbët, s'gjente vërë ku të futej.

Më dukej se kisha fituar një përvojë jo të paktë. Por jo vetëm kaq. Çome kapadani as e çeli grykën më, as m'u kanos, bile as më shikonte në sy. Veç dëgjova se kishte thënë diku: Filani, i biri i filankës, qënka i krisur nga mëntë.

Kur më ardhën në vesh këto fjalë, u krekosha një copë herë.

De ore de, ç'paska pasur të drejtë mësonjësi im Stefani!

* * *

Shumë ditë nuk kaluan dhe Thanasi më thërriti në depon e tij.

— Dëgjo, djali im, më tha, ata që na sulmuan, i vumë përpara e u dhamë një dru të shëndoshë që mos e harrojnë kurrë, por e keqja është se një mik na la në bal-

të e një armik tjetër edhe më i madh se Italia na u vërsul në një front tjetër. Ne po hiqemi, Vasil, por lufta nuk ka mbaruar; në fund të fundit ne do të fitojmë. Ti kurrë mos harro se çfarë të ka shpjeguar mësonjësi yt Stefani, se i vogli e mund të mardhin... Tashti eja e merr pushkë sa të duash.

Këtu nuk u përmbajta dot dhe ja ktheva:

— Mos pandehësh se jam bosh, kam edhe armë të tjera.

— Mirë, mirë, po shpejt nxito dhe kur të vijë Stefani, mësonjësi yt, atij t'ja dorëzosh të gjitha. T'i thuash edhe këto: Hekuri ndahet në tre lloje: ka hekur që duhet punuar e ndarë nga balta, ka tjetër hekur që duhet punuar në farkë dhe i duhet dhënë në ujë, ka dhe një lloj tjetër, i cili del i pastër drejt nga mademi; prej këtij të fundit ke një copë në dorë.

— Mirë, — ja ktheva, — po ti do takohesh me Stefanë?

— Kur të takova ty është një lloj sikur kam takuar atë, — kështu i thuaj. — Tashti merr çfarë të mundësh, veç hap sytë mos u mundo të çelësh bombat e dorës.

— Jo, jo, mos ki merak. Atë punë të

keqe nuk e bëj, se e pashë Sotir Gjiken që hiqej si teknik bombash e mbet pa sy; lere atë tjetrin pa kokë, s'e nëmërojmë, se njeriu pa kokë nuk nëmërohet.

Me Thanasin nuk mundëm të mbarojmë bisedën, sepse u ndjenë utërима aeroplanësh përmbi fshat. Unë s'kisha ndër mend të tundem vëndit, por Thanasi më rrëmbeu për krahu e si erë e marrë çatisëm te përroi tutje lumit. Sa zumë vend ne, na erdhën në vesh ca fishkëllima të mprehta e të forta që nuk i kisha dëgjuar tjetër herë. Pastaj toka u drodh dhe gjëmuan ca plasje të llahtarshme.

— Bombardojnë aeroplanat e gjermanit, — më shpjegoi Thanasi, mu në vesh, — mos luaj vëndit.

Bombardimi armik nuk ishte i gjatë dhe u dëgjuan motorët tek largoheshin drejt perëndimit. Thanasi u ngrit, u përcuallëm bashkë dhe iku.

* * *

Më pastaj ardhën kohë të tjera. Italianët na u kthyen përsëri në fshat. Por ~~ta-~~shti ndjehesha më i rritur e nuk bëja më shaka as me bletë as me bomba. Për të shfryrë inatin dhe urrejtjen, italianët i grabitën grekët dhe nuk u lanë gjë për të

ngrënë. Në fqinjët tanë u bë zi e madhe buke. Rrugët tona u mbushën plot me grekër të uritur, që vinin katundeve tona për të kërkuar ushqim e strehë. Asnjëri nuk doli fshatrave për të folur, asnjëri nuk shkruante në gazetë (atëhere as që kishim gazetë) për fshatarët tanë, nga ishin e nga s'ishin, silleshin si ta kishin bërë me fjalë dhe kështu asnjë grek i uritur nuk u kthye duarbosh, asnjë grek nuk doli barkthate nga vendi ynë. Njerëzit tanë silleshin me bujari ndaj fqinjëve të mbetur keq.

Edhe nëna ime nuk mbetej pas. Sa grekë vinin në oborrin tonë e shtroheshin për të ngrënë, nëna u vinte përpara çka na ndodhej dhe i pyeste:

— Po një ushtar Thanas... Thanas a e njihni?

Kurrë nuk gjetëm njeri që ta njihnte Thanasin tim dhe kurrë nuk mësova dot se ku vajti e ku mbaroi.

Në këto kohë u kthye edhe Mitreja nga fshati i afërm ku rrinte i fshehur.

Kur hynin karvanët me grekë të uritur, shumëkush mendoi se Mitreja nuk do t'u jepte gjë. Po nuk ndodhi kështu. Qiraxhiu nuk u nda nga fshati. — Populli i mjerë nuk ka faj, — thoshte ai.

Kohët kalonin. Tashti isha rritur e kisha mbushur të katërmbëdhjetë vjetët. Po edhe pse nga trupi vija i pakët, më dukej se guximin e kisha të madh. E si të mos e kisha syrin pishë e kokën lart kur «kështjella» ime, prapa shtëpisë, rënkonte akoma nga barra e rëndë e armëve? Vrisja mëndjen si të bëj e qysh të veproj. Më në fund iu hapa shoqes sime Lenës. Bëra kështu, sepse gjithnjë ma desh zemra të isha afër saj, të kuvendoja me 'të, ta shihja në sy, në fytyrë dhe ca më shumë të ndaja me 'të, një të fshehtë. Ja, si motër e desha, nuk e di as unë si e qysh, ndofta shkuar motrës. Dhe po të doni ju të dini më shumë për mua e për atë, për kohën apo për vendin, unë kam bërë be mos t'ju tregoj, sepse sikush ka të fshehtat e veta të vogjëlisë e këto nuk qiten në pazar.

Shoqja ime më dukej më e pjekur se unë. Mua më vinte inat por ç'ti bësh, ja që vajzat nga një herë rriten më shpejt.

— Ti, — më tha ajo, — në je trim, dil malit me partizanët!

Mirë thoshte Lena, këtë e kisha menduar edhe vetë po si arrihej kjo? Sepse më delnin përpara shumë pengesa e ngatërresa. Bie fjala, a do më qasnin mua partizanët

në çetën e tyre? Po ja se këtë e linim për në fund, po ku t'i gjeja? Ku t'i takoja?

Mbrëmjeve, pas darke kur mbuloja kokën me jorgan për të fjetur, mbyllja sytë dhe me imagjinatën time bridhja maleve me partizanët. Diku takoja edhe Stefanin, i tregoja edhe fjalët e grekut Thanas, pastaj fshija pushkën me kujdes, bija në luftime, luftoja si trim; euh, sa armiq shtrijsa unë përtokë! Me dhjetra, me qindra; e ktheja botën përmbys. Po mos u nxitoni të besoni se vërtet i bëja këto, jua thashë që në krye, këto i bëja me përfytyrimin tim dhe me kokën ndën jorgan. Pastaj kur përfytyrimi i kapërxente të gjitha kufitë e arsyes, rendja nëpër beteja, kaloja midis gjylesh që pëlçisnin gjersa dalë ngadale më merrte gjumi. Dhe kur më kapte gjumi shihja ëndër sikur kisha një barrë mustaqe, e isha rritur e bërë goxha burrë.

Por në fillim unë nuk i takova partizanët ballë për ballë. Më parë dëgjova e pashë diçka që kryen ata.

Sot e kësaj dite kur dëgjoj këngën e vjetër që atëhere ua këndonim milicëve, menjëherë më çfaqet para sysh ajo kohë e ato ditë të largëta.

stra prej zinxhiri i përdridhej dhe përsëri ikte me trokth duke gulçuar e turfulluar.

Tashti të shtëna armësh nuk ndjeheshin më. veç era frynte fort, ngrinte lart pluhur nga rruga e malit, përshkëndiste bisqet e ferrave, rrëzonte fletët e drurëve. Ne qëndronim në vend si të ngrirë. Një tufë plumbash fishkëlloi lart mbi ne. Lena u përplas ndër këmbët e mia, mua m'u drodh njëri gju edhe m'u hepua, por këtu duhej trimëri. Të mos pandehte Lena se isha trëmbur. Pra unë qëndrova qiri më këmbë gati ta mbroj atë gjer në fund. — Ulu, ulu, më thërriste ajo e më tërhiqte pas xhakete. Por unë e shikoja me krenari sikur desha t'i them: — Pse, ç'jam unë, frikacak? Jo, unë jam tamam burrë!

Një njeri u duk tek rendëte ku sytë këmbët në rrugën e malit. Kur u qas ne e njohëm menjëherë. Ishte Lame Spahiu, Lame zdapi, Lame katrani... Dollakët i vareshin pas këmbëve, buzët i kishin zënë shirit, kokën e kish pa kapellë, ishte i ndragur, i lagur, i dërmuar, i lodhur. Gjuhën e mbante qitur jashtë një pëllëmbë si qeni në vapë. Me gjithë atë ai rendëte, zvarisej i kërrusur duke u lëkundur si gogozhel. Armët nuk i kishte,

këpucët kushedi ku i kishte flakur, vezmet kushedi se nga i pat lënë dhe qante si fëmijë. Iu mblodhën rreth një tufë njerëz. Në sytë e mi Lame Spahiu ra e u përmbys përgjithnjë. Ai goxha burrë na qënkej një frikacak, një lepur e asgjë më shumë.

— Ç'të ka gjetur kështu, Lame?

— Pa... par... part...

Partizanët desh të thoshte, por fjalën s'e mbaronte dot, se i pritej fryma. Pëllëmbën e mbante diku nga e djathta e barkut. Dikush pandehu se atje që plagosur, po pastaj u muar vesh se i dhimbte ana e barkut prej lodhjes.

— Po ti do t'i zhdukje partizanët, o Lame!

Hë, hë. Lame lepur i mezi përgjigjej e qante gjithnjë.

— M'i... m'i vranë dy shokë.


— Vetëm dy?

— Po, dy, njëri që italian.

— Hajt, dhe më kokën tënde.

Ky ishte luftimi i parë që kryen partizanët afër fshatit tim. Partizanët nuk zbritën më poshtë, po u ngjitën sërish përjetë.

Mbaj mend se nesërejt ngjau diçka që burrat e fshatit e prisnin, kurse unë as që



e shkoja ndër mënd. Isha te lëmi e nëna më pat lënë atje të ruaj nga shpezët misrin e ndehur mbi çergë. Mërzitesha vetëm atje dhe thërrita shoqen time, Lenën. Në fillim ajo nuk desh të vinte, por i premtova ta hamë bashkë bukën me gjizë që më kishte dhënë nëna.

— Jo, — tha ajo, — nuk e kam hallin te gjiza, unë do vij, po...

Ngrita kryet dhe e shikova në sy. Një kaçurrel flokësh i varej mbi ballë e gjer mbi pushin e kuq të faqeve.

— ...po, kur do dalësh partizan?

Ishim me këto fjalë në gojë kur ndjeva ndër hundë një erë të rëndë benzine; më pastaj zhurmë motorash. Një kamjon italian hyri në fshat, pastaj dy, tre. Ardhën e qëndruan te lëmenjtë ku isha unë me shoqen time. Në çast arat e shtigjet an e mbanë u mbushën me milicë. Nëpër ngjyrat e bukura të vjeshtës nxinin kapuçet e tyre të errëta, kurse xhufkat e zeza u vareshin e u lëkundeshin mbi gjoks e mbi shpinë si këmborë lugetësh. Oficerët italianë thirrën burrat e fshatit atje e nisën t'i pyesin, t'i gjykojnë, t'i shajnë, t'u kërcënohen.

— Ju strehoni partizanët, ju na vratë



milicët, ju u tallët me Lame Spahinë, ju...
ju... ju...!

Dhe ai që nuk pandehej, ai doli në krye të burrave dhe mori fjalën. Ky ishte Jano Boshari, lopar i fshatit. E kush e vinte Janon në këndar? Por Janua na paske qënë burrë tamam. Vërtet i pakët nga trupi, vërtet trokë nga kamja, po zemrën e paske plot zjarr e barut.

— Daleni, ore milicë, daleni, ore zabitë, përse na kanoseni ne njerëzve pa armë? Ja, ore, tek janë majë malit ata djemtë me yje, shkoni atje e rrihni gjoksin; ata ju presin si ju ka hie...

Jano Boshari do fliste akoma, mbase s'do ta linin të fliste, mbase do ta kapnin për gryke kur... krisi përsëri që nga korieja e thanave. Që mos shtriheshim përtokë, unë dhe shoqja ime kapëm nga një strumbullar dhe u fshehëm pas tyre. Plumbat fërshëllenin an' e qark. Hynë në valle edhe batore mitrolozësh, plasën bomba, u dëgjuan thirrje e urra... Pastaj nga kodrat pranë u derdhën një sërë djemash me yje në ballë. Nuk ishin shumë, as pesëdhjetë, jo, por italianët ua mbathën këmbëve, se, si thotë një fjalë e popullit, guri rëndon në vendin e vet.

Ja, ky ishte takimi im i parë me partizanët, ky ishte edhe rasti i parë që me sytë e mi shihja një njësi të vogël trimash kur mundnin një kompani të madhe italianësh.

Por, si u miqësova me partizanët, si shtrouam fjalë e si u muarëm vesh, është një punë e gjatë. Fundi i fjalës unë shkova partizan në çetë dhe armët e kështjellës sime i muarën të gjitha luftëtarët e maleve.

Tashti zemra ime e vogël prej luftëtari kishte tri dëshira: I vogli ta mundë të madhin; të gjeja malit, veshur partizan, mësonjësin tim Stefanin; dhe dëshira ime e tretë ishte pak e fshehtë: desha të ngjishe-sha me armë të ndriçme, me kollan lëkure në bel, me yll të kuq prej ari në ballë, t'i kisha mustaqet spicë e të kaloja nëpër fshat me kapellë mbi sy mu përpara portës së Lenës, që do çuditej e do mbetej me gojë hapur!

Shokët nuk më thërrisnin as Vasil, as partizan, por pionier. Ditët e para nuk e dija fare ç'do të thoshte ky emër, po pastaj, kur e mësova, më vinte mirë ta dëgjoja orë e çast.

T'ju them të drejtën, ditën e parë kur ramë në luftë, unë u habita. Jo nga frika, kurrsesi, as tër s'ma bënte veshi, por u

mahnita nga pëlcitjet e tmerëshme të gjyleve të topit.


Ishte ardhur dimëri, po ishte një dimër i rëndë, ngarkuar keq me dëborë e me cikma të mprehta. Krahina ku sillej çeta ime ishte fushë, kështuqë e patëm pisk, sepse italianët qenë lëshuar fshatrave me tanke e autoblanda. Prandaj u hoqëm thellë maleve e rrinim nëpër shpella e guva. Kaqe ditë kaluam me mish lepuri të pakripur. Po barku do bukë. Pashë komisar Mitatin me gishtin në tëmth, pashë komandant Qemalin me kokën ndër duar. Pastaj u hoqën më nj'anë, pleqësuan punën më nge e na folën të gjithëve:

— Burrat më mirë vdesin nga plumbi se sa nga uria. Armiku po na ndjek e na gjurmon në të gjithë anët, por ne do sulmojmë qendrën e milicëve në Zagush!

Unë rraha këmbën përtokë e dorën për kondaku, por një shok aty pranë e hapi gojën sa një kamare nga habia:

— Qysh, ore shoku komisar! Po a e dini ju se Zagushi është fare pranë qytetit e ndën topat e armikut?

— E dimë e dimë, — ja ktheu Qemali, — por ne do ta bëjmë fora. Armikut i duket hunda dyfek e kudo na pret, po që



t'i vërsulemi mu nën hundët e tij, këtë as
që e shkon nëpër mënd. O burrani, pasto-
ni armët mir e mir; në Zagush ka një depo
me ushqime.

Kur ra nata dollëm si kaçakë nga go-
ja e shpellës e bëmë tatëpjetë. Ishim dy-
zet e pesë partizanë, e po të shtojmë edhe
kokën time, arrinim në dyzet e gjashtë.
Por unë nuk e nëmëroja veten, sepse ako-
ma nuk isha pagëzuar me zjarrin e luftës.
Gjithë atyre muajve, kur afrohej rasti për
të rënë në luftim, shokët më dërgonin ko-
rier poshtë e përpjetë.

Pra, asaj nate, si ju thashë, ne iknim
tatëpjetë, veriu ulërinte përpjetë; ne linim
gjurma mbi dëborë, tufani i fshinte aty për

aty, ne nuk pipëtinim, ujqit angullinin; ne zbrisnim fushës, lumi ngelte në vend. Kështu ndodhte vërtet sepse ujërat, sapo delnin nga burimet ngrinin menjëherë. Dimër i keq, jo shaka dhe ftohtë për qahmet, flinte macja me miun.

Komandanti herë herë më qasej, më fliste, më jepte zemër. Unë e dëgjoja me qejf, po kur ma shkante dorën mbi kokë si me përkëdhelje, më vinte të pëlcas. Nuk desha të më përkëdhelnin si çunak, se unë i thosha vetes burrë, jo shaka. Rrija e rrija dhe vija gishtat mbi buzën e sipërme. Ç'e do, fije mustaku nuk kisha. E çfarë nuk jepja sikur të më rriteshin ato të shkreta mustaqe! Nuk desha shumë, jo; kënaqesha edhe me pak, të më djersitnin tridhjetë dyzet fije sa t'i përdridhja një herë e t'i bëja spicë si kapedan Qemali, si komisar Mitati.

Aty nga mesnata iu afruam Zagushit, e, sikurse ju thashë, aty sikur u nemita, më mündonte ankthi. Pa nisi zemra të më këcejë aq sa i ndjeja gjer në vesh të rrahurat e saj në gjoks. Dëgjova komandantin që na foli ngadale:

— Më mirë të mos sillemi anës e anës, se ku dihet, mundet të na diktojnë rojet.



Më mirë vërsulemi drejt e brenda. Ja tek shquhen dobët kulmet e çatisë së asaj kazermës së gjatë. Sikush e di detyrën vetë; o burrani t'u këcejmë drejt e brenda.

Kur iu qasëm fare kazermës, unë u gjendja diku në një qoshk jashtë saj. Që aty pashë hien e armikut, që kalonte ec' e jakë mbi dëborë, dhe këcente nga e ftohta si eshi kur i rrahim teneqen mbi kokë. Di-sa shokë u turrën mbi 'të e ai nuk pati kohë as të kundërshtojë e as të japë alarm.

Të them të drejtën, unë nuk dua të mburrem si ndonjë, që rreh gjoksin e tregon ngjarje që i shpik nga mëndja, i zbururon, u ve duar e këmbë e vetë na del hero. Unë, ore miq e mikësja, ju tregoj me dorë në zemër. Së bardhës i them e bardhë, së zezës e zezë. Pra në atë natë dimri nuk pata rast të përfytem me armikun. Këtë punë e kryen shokë të tjerë, sepse mua dhe dy të tjerëve na thanë: «Qëndroni këtu te qoshi i kazermës, dhe po patë armiq që afrohen, bjeruni.»

Errësira ishte e zezë si katran, sepse edhe dëborë aty kushedi si e qysh ishte spërkatur a situar me pluhur qymyri; larg dëgjohej zhurma e një teneqeje q'e frynte



era, pastaj diku më larg u hodh një urë zjarri nga ndonjë dritare.

Unë dhe shoku pritëm e pritëm sa thamë «mjaft», por njeri i gjallë nuk u qas nga ne. Më dridheshin gjymtyrët, jo nga frika, por nga ankthi, nga pritja, nga kureshtja. Në një farë kohë na u afrua një shok e na lajmëroi:

— Armiku nuk pati kohë të kundërshtojë, as na priste as i shkonte ndër mënd. Nja tridhjetë milicë italianë aty brenda flinin gjumën e parë, tre të tjerë po loznin me letra nën dritën e ca qirinjve, që i kishin ngulur mbi gryka shishesh. Të gjithë ngritën duart e u dorëzuan me të mirë. Tashti ejani edhe ju, se nxitojmë të ikim.

Kur dolla te sheshi i kazermës më zu veshi dihatje, marrje frymë të nxituara, kërcëllitje dhëmbësh nga e ftohta. Këto ishin shenjat që mund të dalloja në armiq të e kapur rob. S'është e pakët të ngrihesh nga gjumi, të ngrihesh prej jataku të ngrohët, të të kapin rob dhe të të qitin jashtë në dëborë!

Për partizanët detyra ishte e qartë, por komisar Mitatit i punoi mëndja akoma. E dëgjova tek u fliste robërve:

— Ne i respektojmë rregullat. Po të si-

lleni si njerëz me mënd në kokë, nuk ju gjen gjë e keqe, jo po ndryshe e kini pisk. Ne na nevojiten ushqimet që kapëm këtu, do ngarkohemi vetë; do ngarkoheni edhe ju. Do t'ju marrim gjer në një farë vendi e pastaj do t'ju lëshojmë; dhe me t'u lëshuar, ju të kërkoni të ikni nga kini ardhur, se po ju zumë përsëri...

Pastaj Qemali na urdhëroi:

— Burrani shokë, ngarkohuni sa të mundni më shumë.

Dhe këtu nuk ishte puna për t'u ngarkuar me armë, as me fishekë, as me barut, këtu duhej ngarkuar me thasë e arka. Se, sikurse ju tregova në fillim, aty ishte depo me ushqime. Pra trimëria e asaj nate provohej te shpina, sa peshë mund të mbartje mbi shpatulla...

Në fillim të atij aksioni sikur më mbetca qejfi që më lanë roje larg te qoshja e nuk pashë armikun tek ngriti duart, por kjo kaloi shpejt e shpejt. Një tjetër shtizë ardh e më shpoi përbrenda. Dëgjova komisarin që thoshte: «Vasilin kujdes, mos i ngarkoni gjë, se është i vogël dhe mundohet.»

Unë u gëlltita dhe, t'ju them drejt, sikur m'u prenë gjunjët fare. Si ore qënkam i vogël unë!, thashë me vete. A nuk kam

mbartur armë në «kështjellën» time? A nuk jam edhe unë partizan si shokët e tjerë? Dale pa të më shihni!

Në kopicën me arka që nxirrnin shokët te sheshi, unë zgjodha më të rëndën. E rrëmbeva si ujku delen. Mendova: të jetë ç'të jetë; të ketë çfarë të ketë, veç të jetë e rëndë. «Një çast m'u drodh kupa e gjurit, diçka më krisi në bel, por unë i thosha vetes partizan e nuk kisha dalë malit që të dëgjoja shokët tek më përkëdhelnin! Nxitoja pas partizanëve që ishin nisur dhe mërmërisja:

— E o të mallkuara mustaqe, që nuk po më delni akoma, se t'ju kisha ju mbi buzë, le të më delte njeri përpara...

Vargun me italianë të ngarkuar e kisha fill pas meje, por nëpër ta e ngatërruar bashkë me ta, si roje apo si shoqëronjës, kalonin edhe shokët tanë. Njërën syresh e dëgjova mirë kur i fliste komisarit:

— Përveç thesit me miell, shoku komisar, rrëmbeva edhe një mitroloz Breda. Do më therte në zemër sikur ta lija. Sapo e pashë u prisha mënj; ishte shtritur pas një pezuli e më dukej sikur do këndonte, si bilbil...

Marshimi i asaj nate ishte shumë i vështirë, i lodhshëm dhe i rëndë. Murlani frynte, dëbora ishte bërë një trup i ngurtë.

Barisja e më dukej sikur shkelja në shpinën e ndonjë tigani. Arkën me makarona e mbaja mbi shpatulla, por qoshja e saj dalengadale zu më hynte në mish sikur të ishte teh; më dhimbte e më digjte supi, një kockë aty zu më fërkohej pas qoshes së arkës. Atëhere qëndrova një çast, ngrita lart edhe dorën tjetër, përkula zverkun, ula kokën, e ula akoma, edhe një lëvizje, edhe një tjetër dhe arka zuri më zvarisej mbi shpatulla gjersa e hodha në supin tjetër.

Dhe zilia më hante përbrënda, se shihja shokë që ishin ngarkuar me nga dy arka, me nga tri, me nga katër. Kishim kaluar ndonja pesëqind metra rrugë, kur plasi batareja. Medoemos na shtinin italianët. Si duket ata vonë muarën vesh çka u ndodhi në Zagush. Ja, këtu u habita nga buçimë shurdhonyjëse e topave. Ajri zu mbante erë leckë të djegur dhe barut, por komandanti na thirri:

— Kaloni pa frikë. Ata lehin si qeni pas hënës; e dinë se u kemi marrë rob gjithë milicët; mos kini gajle, nuk na qëllojnë ne.


Afër agimit iu qasëm një fshati. Këtë nuk e pashë, por e mora me mënd, sepse u dëgjuan qartë lehje qensh, këngë kënde-

zash, e kur ngrita kryet një çast në qiellin e turbullt të dimrit pashë xixa zjarri. Me siguri, mendova, këto dalin nga oxhaqe, ndën oxhaqet ka zjarre, rreth zjarreve nëna të dashura gatuajnë bukë. të tjera pjekin kuleç, të tjera u japin gjji fëmijëve.

— Hej! Hej! Hej! e ku jeni, o shokë!

Ky ishte zëri i komandantit që thërriste drejt katundit. Dhe zëri i tij nëpër veriun që frynte, herë dëgjohej më i fortë, herë më i dobët dhe herë herë humbiste nëpër ulërimën e tufanit.

Pastaj nuk mbanj mënd më shumë. Nuk di si u ndodha atë shpejt ndën një çati shtëpie. Lëshova përtokë arkën time, lëshova pushkën. Zjarri bubulonte në vatër, një gjym bakri ziente në kllanik i varur në një zinxhir dhe nga gryka e gjymit delnin flluska e shkumbë. Patozi që me dhe të kuq, dy tre rrogoza mbi të, një kandile me vaj në ikona. Fare papritur dy tre kalamaj të përgjumur nxuar kokat nga jorganët, qeshnin, gërgiteshin, shponin shoqi shoqin me sy të çapluar nga gazi e habia. Një nënë e mirë m'u qas me dhëmbshuri, më qiti këpucët e ngrira, rrobat e mija kallkan. Duart e saj të dashura e të ngrohta mbështuallën atë butë pëllëmbët e mia të rëna përthonjsh...



— Dale, biro, — më foli, — të qënkan enjtur, dale të t'i fërkoj me dëborë.

Çeli dritaren; nga pezuli i saj mori një masë dëbore dhe m'i fërkoj duart fort e me shpejtësi gjersa ndjeva që gjaku zu më punonte dhe gishtat m'u ngrohën. Dikush shtroi një sofër me bukë e gjellë. Në një misur prej çingoje kishte kaçamak misri, nga një misur tjetër delte një avull prej trahani. U shtrova të ha si i babëzitur. Mbase e mbusha barkun, por nuk ndjeja të ngopur, gjersa një zë erdhi e ma prishi fare terezinë. Zëri ishte i plakut të shtëpisë, zë i ngadalshëm, i shtruar, por sa nopran m'u duk plaku kur tha:

— Këtë çunakun e vogël ta vemë të flerë me kalamanët tanë!

Sa rëndë që më erdhi! Luga më pikoi nga dora, ula kryet dhe përsëri mëndja ime rendi jo larg, fare afër, bile aty mbi fytyrën time: Eh, që nuk më dalin këto të shkreta mustaqe, le të më thonë pastaj se jam i vogël!

Por komandanti, që ishte aty në krye të sofrës, e dinte brengën time. Ai kafshoi buzën e poshtme kur më ra luga nga dora.

— Ky çunaku, si e quan ti, o gjysh, —

foli ai, — ky djalosh vlen sa për dy burra bashkë.

Kaq mbaj mënd për atë natë dhe di se më kapi gjumi me gaz në buzë.

* * *

Dimri që po kalonim ishte ai i vitit 1942. E patëm vështirë, sepse forcat e armikut ishin të shumta, armatimet e tyre ishin të rënda, kurse ne na mundonte dëbora dhe ngrica. Por në fund të fundit, muajt kaluan. Luftimet që kryem gjatë atij dimri ishin të vogla, më shumë të befasishme, në vende ku armiku nuk e pandehte. Pastaj ardhni pranvera.

Sa shumë njerëz të panjohur takoja atyre ditëve! Sa shumë! Kjo ishte për mua një kënaqësi e veçantë. Dhe ishte fare e natyreshme. Një të rrituri nuk i le mbresë hasja me një të panjohur, kurse për një djalë të ri si unë, takimi me njerëz të ndryshëm kurdoherë përmban kërshtëri dhe gëzim. Por të gjithë ata partizanë që takoja dhe të cilët vinin nga larg, unë i pyesja aty për aty:

— A e njihni ju një partizan me emërin Stefan?

Ndonjëri ngrinte supet, ndonjëri, duke kroytur zverkun, thoshte se kishte dëgjuar për një komisar Stefan, kurse një tjetër e njihte fare mirë:

— Qysh, ore, nuk e njoh unë komisar Stefanin! Stefanin e gjatë, Stefanin trim e të pashok!

Atëhere sytë më xixëllonin nga gëzimi, fytyrën ma mbulonte hareja e përplasja duart.

— Po a do të vijë Stefani këtej?

— Besa besën, o shok, nuk di gjë; edhe mund të vijë; Stefani ku ngryset nuk gëdhiet.

Ndodhia që do t'ju tregoj tashti më kujtohet fare kthjellët. Ishte dita e parë e majit. Nga të gjithë anët natyra krenohej me gjelbërim e lule të bardha. Edhe pylli, ku e gdhimë natën, në mbrëmje ishte larush, kurse në mëngjes ishte ndezur më fort me njato bisqe ahu gjithë lëng e me njato fletë të dendura palë palë! Vinte erë pranverë, erë lulesh, erë pylli, aromë poleske dhe unë e ndjeja veten të lehtë, të lehtë si pëllumbat ngjyrë hiri që gugasnin e çanin ajrin e lirë aty rreth.

Na pat thënë komisarit se në një lerishte mali do bëhej një mbledhje e çetave par-

tizane të atyre anëve. Pastaj u hap edhe një fjalë tjetër ndër partizanët, por disa e besonin, disa jo, gjersa u duk sheshit se fjala nuk ishte më kot. Them kështu, sepse komisari ynë, Mitati, dërgohej me detyrë në një zonë tjetër dhe kishte kaq orë që kuvendonte kokë më kokë me komandantin.

Aty nga drekëhera që nga brigjet e malet kundrejt nisën të derdhen tatëpjetë këto çeta djemsh radhë-radhë e grupe-grupe. Zbrisnin, dredhonin, kaptonin shtigje e qaseshin te lerishta gjithë duke kënduar, gjithë duke këcyer, se rini pa këngë e valle nuk ka kurrë nër malet tona. Edhe kënga që kishte dalë atyre ditëve, e re fare, ishte tamam si më porosi:

Malet me blerim mbuluar
Plot me bukuri! Bum!

Te sheshi shihja partizanë tek takoheshin, përqafoheshin, i rrihnin shpatullat njëri tjetrit... Koriet rreth e qark gumëzhnin nga zërat tonë. Në një farë kohe dikush hipi në një kërcu lisi e bërtiti:

— Shokë! Shokë! Mbani qetësi, shokë!

Një palë e prenë këngën në çast, disa këndonin akoma, dikush u foli. E prenë edhe ata, veç një si çekan qëllonte akoma

diku: dang, dang, dang. Mbërthenin një kondak të thyer. Dikush vajti foli edhe gjert atje ku mbërthehej kondaku e qetësia: u vendos. Katërqind e ca partizanë u mblodhëm në një gjysmë rrethi shtruar këmbëkryq. Ata që ishin nga qyteti njihe-shin q'atje tej se nuk qëndronin dot këmbëkryq, por rrinin më gjunjë, më bisnt a ku di unë se si.

Një kolonë e vogël njerëzish dha krye nga shtegu i rrugës lart. Njërit syresh i xixëlluan qelqet e dylbisë, i dyti ndreqi kapelën, kurse i treti fshiu me shaminë e kuqe ballin e djersitur. Në çast m'u desht të vedorën mbi zemër! Pamja përpara meje sikur u drodh, sikur ajrin e valoi zhegu. Dhe unë vija dorën në zjarr se ai partizani me dylbi në gjoks ishte Stefani im! E megjithëse ai kishte mustaqet të dredhura, megjithëse ishte i nxirë në fytyrë, megjithëse dukej më i gjatë, sytë dhe zemra ime s'mund të më gënjenin. Po, po, ai ishte Stefani.

Por, të jesh në moshën që kisha unë, nuk është lehtë të këcesh në mes të sheshit e t'i dalësh përpara një njeriu që po e përshëndetin katërqind e ca burra.

— Vdekje fashizmit, shokë!

— Liri Popullit, shoku komisar!

Disa që e njihnin Stefanin (e si mos e njihnin kur ai ishte djalë i këtyre anëve?) u lëshuan te ai për mirseardhje. Binin krahë më krahë e gjoks më gjoks, ndaheshin një çast, shiheshin sy më sy e përsëri qafoheshin më me duf.

N'atë çast m'u bë sikur dikush më foli në vesh: Çou, ngreu edhe ti, shko e tako komisar Stefanin, mësonjësin tënd, nisë!

Por mua më mbërtheu në vend e papritura dhe nuk munda të lëviz fare. Përsëri u vendos qetësia: do mbahej fjalimi i rastit për ditën e një majit. Tashti mbi kërcurin prej lisi hipi Stefani. Dikush iu qas e nisën të bisedojnë nxituar; dikush nga ne pëshpëriste: Ikën Mitati e na vjen komisar Stefani; këtij i takonte kjo çetë: është djalë i këtyre anëve; ky ja di hallet, ky i njeh, ky...

— Të dashur shokë partizanë, — filloi të flasë Stefani, — sot, dita e një majit, festa e punëtorëve të botës...

Zëri i tij kishte tonin dhe butësinë e ngrohtë të mësonjësit tim. Atë zë unë e njihja mirë, ai zë për mua ishte shumë i dashur. Dhe fill këtu më pushtoi entuziazmi, hareja, zemra m'u ngrit peshë, gjaku sikur më buçiti në kokë, nuk dija se çfarë bëja, pa këceva drejt e më këmbë e bërtita sa më hante në kokë:

— Rroftë dita e një majit! Rroftë komisar Stefani!

Rroftë e rroftë dhe... zhgëdau! ja buçita me pushkë drejt e përpjetë.

Menjëherë rregulli dhe qetësia u prishën. U ndodhën edhe nja dy koka të tjera si unë... zhgëdau, zhgëdau, bamb e bumb... Një rrëmujë më vete. «Dale more», thërrishte njëri prej dorës sime, «kemi festë apo jo? kështu festohet partizance!...»

Komandanti ynë gati u tërbua, nja dy të tjerë u fryjtën bilbilave fort, gjersa u dëgjua përsëri zëri i Stefanit;

— Ç'është kjo që bëni, shokë! turp! a jeni partizanë ju, a kini disiplinë?

Qetësi an' e mb'anë. Përsëri foli Stefani:

— Ai që u bë shkak i pari të prishet rregulli, të dënohet, të hiqet më nj'anë.

Hund' e buzë bashkë më hoqën nga le- rishta, pa më muar pushkën, m'i muarën edhe bombat e dorës. Edhe Stefani më vërejti kur më hiqnin tutje; prisja që ai të më njihte, prisja që të më delte krah, të më thërriste pranë tij, por asgjë e tillë nuk ngjau.

— Sot punëtorët e botës së shtypur shtrëngojnë radhët...

Zërin e Stefanit tashti e dëgjoja vërtet nga larg, po përsëri e dëgjoja. Nisën të më shkojnë djersë të ftohta. U bëra pik' e vrer. Ç'më duhej mua ajo që bëra! Pse të mos vija te Stefani e ta takoja si gjithë të tjerët? Kur po e gjykoja veten time kështu, komisar Mitati vështroi nga unë. Vështtrimet tona u takuan. Ai shpërveshi buzët e ma tundi kokën me inat. De, o hall, de! Desha të ve vetulla, çita edhe sytë. Po tashti?

Kur mbaroi Stefani fjalimin, e rrethuan gjithë shokët e mi, e takonin, e përgëzonin, bisedonin me 'të, kurse të dy rojet që më ruanin mua, ma patën:

-- Të mori dreqi, të mori, ja, ti na mbërtheve këtu.

Buza më dridhej, gryka më dridhej, gjykoja veten e kafshoja gishtat me dhëmbë. Ç'më duhej mua ajo që bëra? Ja, tashti do isha me Stefanin, do ta takoja, do t'i flisja, do më fliste, ehu, sa fjalë do t'i kisha thënë; kurse tashti... tashti vetë Stefani kish dhënë urdhër që të më dënojnë!

Por diçka lëvizi në qënëjen time. Ngrita kryet më mirë. Stefani po rendëte këtej. Stefanit i patën folur për mua, ai nuk më pat njohur kur më pa te sheshi, Stefani im, mësonjësi im!

Sytë m'u mbushën me lot, zemra m'u drodh e sikur m'u shkund në krahëror. Tashti koka ime ishte mbi gjoksin e Stefanit. Unë nuk shqitesha dot prej tij. Isha i mallëngjyer, i gëzuar, i lumtur. Por edhe pa e ngritur kryet, edhe pa e parë në sy, e dija, e kuptoja se edhe Stefani i kishte sytë me lot. E dëgjova kur u foli shokëve me një zë të dredhur :

— Ju nuk e kuptoni dot, e lashë nxënës dhe e gjej shok!

Kaluan orë, pastaj ditë.

Me komisar Stefanin shtruam bisedë të gjatë. Ai më kërkoi hollësi për depon time me armë dhe unë i tregova shkurt e shkurt, pastaj i fola për Thanasin.

— Ai ishte njeri i mirë dhe fjalët e tij të fundit, kur u ndamë, ishin këto: Ka tre lloje hekuri...

Sapo mbarova porosinë mbi tre llojet e hekurit, Stefani ma pat:

— Ti e kupton, kur të foli për hekurin e pastër, ai e kishte fjalën për ty.

Unë ula kryet.

— Kur i flisja dendur për ty, ai thoshte se nuk njoh ndonjë mësonjës shqiptar me emërin Stefan, por në një rast, në një çast, u kujtua, të njihte ty.



— Cili qe ai rast?

— Rasti ishte... atëhere kur i thashë:
«Edhe Stefani, o Thanas, kishte një zakon
të keq si ti, nuk vinte kurrë në kishë».

Këtu Stefani ma preu fjalën dhe më vu
dorën mbi sup.

— Thanasi nuk vinte në kishë, the?

— Po. Nuk vinte, edhe ai fliste si ti,
grykonte si ti, e gjithçka vepronte e fliste
ai mua më ngjiste me fjalët e sjelljet e tua.
U çudita herën e parë kur më foli tamam si
ti dhe më tha: Kur ka i vogli të drejtë dhe
është trim, e mund më të madhin.

Tashti fytyra e Stefanit qeshte e tëra.

— Ai ka qënë shoku ynë, o Vasil, ka
qënë si ne, ka qënë nga fara jonë e shtuar,
kryengritës, revolucionar, ja çka qënë ai!

* * *

Muajtë që ardhën më pastaj nuk ishin
shumë të gëzuar për mua. Komisari
ynë i ri, Stefani, filloi një lojë të çu-
ditëshme me mua. Më mbante gjith-
një larg luftimeve, larg rrezikut dhe
kur i lutesha me dorë në zemër të mos ve-
projë më ashtu, ai nuk dinte sesi të ma
mbushë mëndjen se kishte të drejtë. Kështu
që unë për muaj të tëra u mora me de-

tyrën e korierit. Luftëtarë kemi shumë, më shpjegonte Stefani, por pionerë të vegjël kemi pak, pastaj lufta nuk ka mbaruar. Ti do rritesh në luftë, do kalitesh me të, përse nxitohesh? Kështu që sa herë ai kishte ndër mend të nisej për aksion, më dërgonte diku larg me shërbim e kur kthehesha në njësinë tonë gjithçka kishte mbaruar.

Aty nga korriku i vitit 1943 ishim dyqind e sa shokë në njësinë tonë. Më nuk ishim çetë, por një batalion partizanësh i ndarë në tri kompani. Një ditë prej ditësh, komisari e ndau njësinë, dua të them i nisi dy kompani në rrugë të ndryshme dhe vetë ai, me kompaninë e tretë, u bë gati për aksion. Unë kisha vendosur që mos largohem kurrsesi, por edhe ai, si duket, e kishte vendosur të më marrë me vete.

U nisëm që nga limeri ynë në mes pyllit e bëmë tatëpjetë. As komisari e as komandanti nuk na thanë se për ku nisemi, por të gjithë e kuptuam se ishte një shtegtim i rrezikshëm asaj nate që afrohej. Na thanë veç që të gatitim armët e më shumë nuk duhej. Ecnim në njëshkollonë me pararojë e praparojë. Vende vende kollona qëndronte për çlodhje. Komandanti zgjidhte ndonjë vend gropë e grykë, dërgonte di-

ku më lart dy tre roje e jepte urdhër të ndiznim cigaret. — Veç kini kujdes, shton-te ai, kini kujdes dhe i mbani cigaret mbështjellë në grusht që mos duket gulshi larg.

Unë dilja vullnetar roje në këso rashes se nuk tymosja duhan (zakon të mirë që e kam edhe sot) e që nga majolja ime e rojes shihja shokët. Në errësirën e zezë shquheshin majëzat e kuqe që regëtinin, ndizeshin e shuheshin aty për aty ashtu si yjet kur këputen nëpër qiell. Në një çlodhje të tillë, komisari hyri në mes të kompanisë e foli sa mundej më me ngadale:

— Do t'u ngremë pritë fashistëve në xhade. Gjatë qëndrimit në pusi do mos ndjehet as zhurma më e vogël. Kur të afrohet armiku aty nga mëngjesi, ju do qëlloni me urdhër e veç më hava. Do bëni kështu, sepse kollona që presim është plot me fshatarë, të cilët italianët i kanë arrestuar dhe i internojnë në Itali...

Ishte errësirë e nuk mundja të shoh sytë e shokëve sesi ndritnin nga gëzimi. Se ne shkonim në luftë me gaz. Ishim vullnetarë, ishim djem të rinj e gjaku na ziente. Por megjithëse nuk shihja gjë, dëgjoja pëshpëritjet e ethëshme, fërkimet e armëve, rrahjen e tokës me këmbë, e jo veç nje-

ri e kapte armën për gryke e i puthte kon-
dakun. Kur arriti mesnata ne ecnim ako-
ma. Rrugës hasnim karvane me fshatarë
e kuaj që mbartnin duaj me grurë; druhe-
shim të na shihte njeri e bënim më nj'anë.
Aty këtu, ndonjëri shkëputej nga kollona
se pengohet ndër rrënjë a përmbysesj në
hendek, por zë nuk nxirrte. Niste atëhere
një farë kuvendimi duke cicëruar si kuril-
je a si tojë, duke angullitur si qen a duke
rrahur me thua mbi pagur. Këto ishin pa-
rrullat për të lajmëruar shokët. Pastaj, kur
shoku i shkëputur afrohej, shtegtimi nis-
te përsëri. Në një vend qëndruam me një
urdhër të beftë. Ishte një arë me ster-
nishta:

— Secili të fshihet pas duajve me gru-
rë!

Sa zura vend ku duhej, pashë dy si sy
të mëdhenj prej drite, që u lëshuan diku
larg nga faqja e një mali e nisën të shëtis-
nin poshtë e lart. Në qiell dukeshin gul-
shet e ndriçëm, faqja e malit lllapëtinte.
Italianët hidhnin dritë me prozhektorë për
të hetuar lëvizjet e partizanëve. Ata na
kërkonin në mal e ne zbrisnim në fushë.
Dy sytë e mëdhenj gjithnjë silleshin pas
pllajës së malit, të dy njëherit, të dy bash-

kë, afër e afër, pastaj çarteshin një çast, njëri shkonte më tej, tjetri më tëhu, si të ishin sy vëngëroshë të ndonjë përbindëshi përrallash. Hetimi me drita vijoi ndonjë gjysmë orë, pastaj, papritur, sytë e prozhektorit u skuqën fort, drita u tërhoq si dy gjuhëza flakë që përbindëshi i gëlltiti përsëri në gojën e vet.

U ngritëm më këmbë e u kapëm dorë-përdorë, sepse errësira u bë më e zezë. Kalonim nëpër korije të dendura me shelgje e plepa.

— Këtu qëndroni, hapuni!

Zumë të zvarisemi, të kapërxejmë hendeqe; dikush përmysej, dikush ngrihej. M'u përplas koka në një shelg, hunda më dhëmbi fort sikur më sëmboi brenda në kokë e më shkuan lot nga sytë. U ndamë më dysh dhe xhadenë e muarëm në mes. Vendi ishte si grykë; ndën këmbët tona mezi shquhej xhadeja.

Errësirë an' e kënd. Larg ndonjë kandile nëpër fshatra, ca më larg ndonjë zjarr pyjeve. Zhurma e lumit ushëtinte, frynte erë nga lindja, vuuu ja kthente një tjetër prej perëndimit; hynte edhe veriu në mes, por i lehtë, si erë behari. E më ngatërroshin ndër hundë aromat e luleve, të ba-

rit, të tërfilit që sapo kishte zënë gonxhe. Diçka nisi sikur të grindej diku larg. Ngjiste si mjaullima e një maçoku të sëmurë: mjau, mjau, mau, mau!

— Hej, ju të gjithë atje, vjen një automobil, mos shtini.

Dritat e automobilit mezi shquheshin, si dy qirinj të mekur. Si dukej, shoferi u kishte vënë maskë dritave. Kamion ishte ai që na kaloi në xhade. Por ne nuk e ngajtim. Ne prisnim kollonën e caktuar dhe komandanti zinte be e rrufe për saktësinë e njoftimit që kishte marrë. Nuk dija sa ishte ora dhe as që pyesja. Mendova: le të jetë sa të jetë, kur të afrohet agimi zë e zbardh. . .

Nisi flladi të më përcëlloi në ballë, nisën të më shkojnë mornica të holla në shpinë, ijet nisën të më mardhin, fërgëlloja si peshku në të thatë e nisa të fërkoj zverkun e tëmthat. Medoemos zemra më rrihte fort e dashur pa dashur mëndja ime desh të përfytyrojë orët e ardhëshme kur do kërcisnin armët. Pastaj desha t'i shmang ato mendime. E kaloja mëndjen te shtëpia ime, te nëna, te pulishti, pse jo? edhe te kërrici që priste ta samarosim në vjeshtë! Po përsëri mëndja ime ngulmonte aty në

vend, vetëm aty, ashtu si gjuha shkon vetiu te dhëmballa që dhemb.

Fërshëllyen raketat anës së lumit. Dita u hap. Ishte një e premtë plot dritë. Dielli u ngrit e na ledhatoi me rrezet e ngrohta. Ditë behari. Një tjetër zhurmë në xhade. Vinte nga ana që prisnim dhe fill në çast zëri i Stefanit tonë. Nuk e dëgjoja mirë çfarë thoshte, por e merrja me mënd dhe zemra më rrihte me vrull.

Shokët kundrejt ishin maskuar me ferra; pas ferrave gurë, pas gurëve ata vetë. Komisar Stefani rendi në xhade duke zbritur i kërrusur nëpër rrëzim. Diçka mbante ndër duar. Pastaj lëshoi një, dy, tri... Oj! Po ç'ishin ato? I vura re mirë. Bajga kafshe. Por diçka kisha dëgjuar që më parë. Ato që vendoste komisari në rrugë ishin mina të sajuara në formë bajgash. E mora me mënd se autokolona që vinte kishte autoblindë përpara. Dhe nuk u gabova aspak. Ajo doli te kthesa tej duke prerë ajrin me tytën e mitrolozit të saj. Ishte e shëmtuar, e shpejtë, e në ngjyrë të zhabjakut. Nga kulla e saj xixëlluan dy sy të mprehtë. Futa hundët përtokë. Toka u drodh. Ngrita kokën një çast e lart në hava pashë hekurishte, goma, forma të ngatë-

rruara që bënin kollotumba në erë. Krizma e parë gjëmoi e tmershme pastaj nisën «çekiçet» e pushkëve tona: Ta, ta, ta!

Është vështirë të përshkruash zhurmat e luftës. Ato janë të mprehta, të forta e njëherit të ngatërruara. Armët buçisnin, njerëzit thërrisnin, disa me klithma frike, të tjerë me britma kanosëse dhe plumbat fishkullonin me një shpejtësi që të ngjeth-te trupin.

— Me dorë, ore, me dorë!

— Gjallë t'i kapim pipinot e djallit!

U hodhëm përpara. As me vrap as me ecje, as me marshim e as me vërsulje. Hedhja jonë i ngjiste më shumë asaj lëvizjeje që bëjnë njerëzit kur që nga bankina e bregut hidhen në det.

Dhe nëpër rrëmujën e sulmit, kur plumbat gërvishtnin koren e tokës, dëgjo-va emërin tim që përsëritej me ngulm:

— Vasili! Ku është Vasili!

E kuptova menjëherë. Nuk më kërkoi për ndonjë punë të posaçme dhe bash prandaj më ardhi keq. Më ardhi keq, sepse dëgjoja përsëri Stefanin tek thërriste:

— Kujdes Vasilin, kujdes pionerin e vogël!

Në xhadenë e gjërë një rrëmujë e ma-

dhe sa nuk njihete qeni të zotin. Në hendek një fashist i vrarë, një shok i tij mbytur me thonj nga fshatarët e çliruar. Fshatarët që ishin të lidhur me litarë e që sapo i shpëtuam, rrëmbyen armët menjëherë. Stefani më dukej burri më i madh në botë, edhe më i bukuri, edhe më i fuqishmi.

— O burra, shokë partizanë, — thërriste ai, — shpejt, me vrap, përpjetë fushës, shpejt. Vasil, ku je?

Ushtarët e armikut ishin të përzjerë, borsalierë me pendë ndër helmetat, alpinë me pendë në kapelet, karabinierë me bustinë si qeramidhe, njëri e kishte kapellën si govatë, të tjerët me xhufka të zeza, me mjekra të zeza, me këmishë të zeza, domosdo edhe me zemra të zeza.

— Mblidhni armët, fishekët, bombat!

Për të mbledhur xhepane lufte, Stefani mund t'i thoshte ndonjë tjetri, por jo mua! Se unë, or tungjatjeta, që sapo më zunë këmbët në xhade u sula drejt e mbi armët e armikut, tamam si ai miku i uritur me lugë në dorë kur turret për çorbë të ngroh-të.

Fshatarët i çliruar të gjithë e vargu i tyre që i madh, ishin gati dyqind vetë. Po kur u bëmë ne gati të largoheshim, kur




u ngarkuam me armë, kur i mblodhëm robërit në një orman dhe pritej që Stefani t'i lironte dhe t'u fliste diçka, unë desha të di sa janë. Sikurse e dini, llogaria ishte te i madhi me të voglin! U qasa ndër ta dhe nisa t'i nëmëroj: një, dy, pesë, dhjetë, tridhjetë...

Gjer te tridhjeta arrita mirë, kur më doli përpara një bersalier i gjatë e rondokop, të cilit i kish hyrë lepuri në bark dhe u përkul nga unë sa që xhufka e pendëve të tij më fshiku hundën time të vrarë. Një goxha burri u kërrus më dysh para meje si një thikë xhepi kur e mbyllim. Mërmëroi:

— **Siamo çentocinkuanta** (jemi njëqind e pesëdhjetë).

— Ikë ore tutje, qënki njëqind e pesëdhjetë, posi, posi!... Zotrote nëmëron kokët rëndom. Ikë tutje, zoti bersalier, se ato kokë që kafshuan tokë s'mund të m'i futësh në defter. Ti nuk di të bësh llogari as hesap, quaje si të duash. Llogari di të bëj vetë, se për këtë llogari të shkretë kam vrarë mëndjen kaq kohë e kam marrë pushkën në dorë. Ja, pra, llogaria ime: I vogli e mund të madhin, more vesh? Ju ishit njëqind e pesëdhjetë, ne jemi vetëm



gjashtëdhjetë dhe ju hymë dorë, ju bëmë fërtele; ja hendeku, ku mbaroi autoblin-da juaj, more vesh?

Kështu i fola bersalierit, por ai rrin-te i kërrusur para meje, mezi më shihte me kokën të kërrusur dhe mërmëriste:

— Non kapito niente, no! (Nuk kup-toj hiç!).

— Epo, nëqoftëse ti nuk kupton, mua aq më bën. Në djall të veç. I vogli trim dhe i drejtë e mund të madhin!

Nismë tërheqjen të ngarkuar me ar-më. Nuk lamë gjë pa marrë, sepse bashkë me ne u ngarkuan edhe fshatarët e çliru-ar. Njëri syresh nxitonte para meje me disa pushkë varur krahëqafë, kurse ndër-duar mbante ndenjëset me susta të kami-oneve. Dhe ishim tek një livadh, ishim du-ke kaluar nëpër një kope qesh që kullos-nin kur... vuu... një aeroplan armik, na u vërsul që lart me të shtëna mitrolo-zi. Ne u bëmë rrafsh me tokën, por në çast e ndjeva se menjëherë diçka më kaf-shoi në kupën e gjurit. Kur e vura dorën atje, diçka më ngrohu, diçka rrodhi. Ishte gjaku im. Shokët m'u afruan, ma lidhën plagën dhe kështu mbarova në spitalin

u mundova t'ja fsheh shqetësimin tim, ai më kuptoi. Dhe në të vërtetë dashur pa dashur rrija ca si i sëndisur; kur i tregova Stefanit brengën time, ai ma ktheu:

— Dale të ta shoh unë plagën.

Zgjidha fashon e bardhë. Stefani e vështroi me nge këtej, andej, po çështja e përkuljes së këmbës nuk mund të kuptohej. Që nga mesi i kofshës e gjer në mes të pulpës më kishin shtritur një copë dërrasë të hollë, ma kishin lidhur poshtë e lart dhe këmbën s'mund ta përkulja. Stefani ma lidhi plagën dhe ma pat:

— Doktorin ynë ka mësuar zanatin për njerëz të Evropës që e kanë lëkurën si fletë cigareje, që janë ushqyer me çokolata e flejnë mbi pupla. Ne durojmë më shumë, Vasil, ne kemi organet e trupit më të regjura, më të kalitura. Nuk e merr dot me mënd mjeku ynë se ti je rritur e je bërë goxha djal e goxha trim duke u ushqyer me misërnike e lëng armeje...

Këto fjalë ma ngrohën zemërën dhe nisi mëndja ime përsëri të merret me punët e luftës dhe të botës së madhe. I fola Stefanit:

— Po ç'kemi asaj lufte, shoku komisar? Si duket, i vogli kundër të madhit...

— Njërit ja hëngrëm kokën...

Stefani do vijonte akoma kur na hyri në bisedë një partizan plak, që pat ardhur vizitë te shoku që kisha pranë. Partizani plak ishte keq i parrojtur dhe qimet e faqeve, të ngritura si drizë, i kishte gjysmë thinjoshe. Nuk më ardhi mirë që ai ishte aq i parrojtur. Ai sikur e kuptoi mendimin tim dhe ma pat: U mundova të rruhem duke mprehur thikën pas gurit, po ish punë që s'bëhej; brisqe nuk kemi; i dhashë karar se po nuk na ardhën brisqe do ta djeg mjekrën ca nga ca... e ku e patëm fjalën. Ti, çunak (këtu e shikova vëngër), e kishe hallin te lufta, te gjermani... e po dëgjo këtu... vatani ynë është vakëf, vend i shenjtë, kush shkel me dhunë këtu, do hajë kokën e tij dhe do bëhet fir...

Plaku tha e tha shumë të tjera; Stefani më la shëndetin, por mua më mbeti mëndja te kupa e gjurit. Ardh e m'u tipos në kokë një mendim i çuditshëm: Më patën folur për lëngun e gjurit, më patën thënë se ai lëng është pak i trashë, si zamkë. Nga këto shpjegime u shtang në trurin tim një krahasim i çuditëshëm: Thosha: lëngu i gjurit ngjet në lëngun e armesë;

unë kam pirë lëng armeje me tonelata, do pi akoma dhe vetiu ai lëng i uruar, i thartë dhe pak i trashë, do shkojë sadopak dhe në kupën e gjurit tim.

Por me këto mendime dhe me këto halle, kalonin ditë, javë, muaj. Luftë nuk dëgjoja, luftë nuk shihja, por e ndjeja që kërciste e egër dhe e ashpër ndër malet tona. Dendur vinin shokë të plagosur dhe jo vetëm tregimet e tyre, por edhe thirrjet në kllapi të të plagosurve flisnin e tregonin më shumë për betejat.

Dimri kaloi. Ishte buzë pranvere kur m'i hoqën krejt fashot nga plaga dhe dërrasën e vogël nga këmba. Bëra ta përkul këmbën në gju por ishte punë që s'bëhej. Mjeku përsëri mblodhi buzët. Mua më shkuan djersë të ftohta. Edhe hamendjet time mbi lëngun e armesë nuk po jepnin pemë. — Dëgjo këtu, — më foli doktori, — gjithë kohën bëj një punë, fërko muskulat rrotull gjurit, ngacmoji, zbuti me vaj, mundohu ta përkulësh gjurin, mundohu gjithnjë, kështu diçka mund të bëhet.

Nisa or e çast të merrem me gjurin. Disa herë mërzhitesha, lodheshja, po kur përfytyroja veten topall... nisja përsëri

më me vrull. Dhe ta dini, lëngun e armesë nuk e ndaja nga poçi im. Po edhe sikur të doja ta largoja, ish punë që s'behej; ne s'kishim ushqime dhe turshitë nuk ndaheshin kurrë nga silla e të plagosurve. Dhe nuk kaluan as pesë ditë kur ndjeva shenjën e parë. Gjuri im krisi dhe u përkul fare pak. Fillova të këcej nëpër patozin e guvës ndën sytë e shokëve të plagosur që gëzoheshin edhe ata me gazin tim. Në krye të njëzet ditëve, gjuri im përkulej mjaft mirë dhe kur ardhi Stefani përkuleshin një lloj të dy gjunjët e mi! Kur i tregova komisarit tim mbi përngjasimin midis lëngut të armesë dhe lëngut të gjurit, ai desh u shqye gazit.

— Jo, Vasil — ma ktheu ai — lëngun e armesë e pijmë nga nevoja, nga moskamja; ty të shëroi zemra jote, vullneti yt, ajri i kulluar i maleve, ujët e burimit. Tashti eja...

Kur duallëm nga guva, jashtë kishte rënë një mjergull e dëndur pas tokës, e dielli ndriçonte atje lart me tërë shkëlqimin e tij.



Kishte ardhur pranvera. Kjo ishte pranvera e tretë që më gjente luftëtar në mal. Stefani e thoshte me gojën plot se ajo ishte pranvera e fundit në luftë. Dhe shenjatat e mira ishin jo të pakta. Gjermanët po hanin dru në të gjitha frontet e luftës, kudo ishin në tërheqje. Po edhe se punët tregonin kështu, gjermanët ishin gjermanë, të egër dhe të vendosur gjer në fund. Vriteshin dhe të gjallë nuk jepeshin. Një nga pleqtë e batalionit tonë thoshte duke ndezur eshkën me gur zjarri e masat:

— Kur ja futin dashit thikën në grykë, atëhere përpëlitet më keq.

Malet ishin mbushur plot fletë e blerim kur gjermani vendosi të na sulmojë edhe një herë në front të gjerë. Ishte aty nga fundi i muajit maj. Kësaj radhe gjermanët ishin më të shumtë, kishin pas edhe ballistë edhe xhandarë. Batalioni ku bëja pjesë unë ishte mbledhur përfund një korieje. Ndën ne kalonte lumi, kurse m'at'anë lumit shtriheshin një sërë jonxhesh. Në këtë kohë nga rruga përtej ndihej rendja në trokth e një kali dhe zilja e tij tek tringëlante sipas hedhjeve të kafshës. Askush nuk i dha rëndësi kalit në trokth kur nëpër dri-

zat e pyllit unë pashë kalorësin që këceu nga kali duke tërhequr pas një farë tallaganeje, kjo iu ngatërrua nëpër këmbë. Ai e shkeli dhe rendi nga ne. Me gjysmë fryme i riardhuri na tregoi se në fshatin aty afër kishin hyrë gjermanët. Ne brofëm më këmbë dhe rendëm përpjetë kories. Hipëm majë aheve dhe vështruam. Ushtarët e armikut lëvrinin si milingonjat diku në një lëndinë. Stefani që vështroi me dylbi tha se disa po rëmihnin tokën për të vendosur topat, të tjerë hapnin llogore, kurse të tjerë akoma po prisnin degët dhe maskonin armët e rënda.

— Plani i gjermanëve është po ai, — shpjegoi shpejt e shpejt Stefani; — ata e dinë se forcat tona ndodhen pranë dhe duan të hapin luftë frontale, duan të bëjmë dëshirën e tyre dhe të na çfarosin me armët e rënda. Tmeri i tyre është lufta e çetave: këtë ata nuk e duan...

Komisari nuk mbaroi dot fjalën e tij kur shungulluan krizmat e topave. Mendova se dikush do kishte spiunuar vendqëndrimin tonë, sepse predhat ranë pikërisht anës së lumit atje ku kishim qënë disa minuta më parë. Po pastaj nuk di se çfarë ngjau; predhat e gjermanit nisën të qëllonin në mu në grumbullin tonë. Qëllonin me një

dendësi të tillë sa qielli u mbulua nga tymi i gjyleve, krizmat mend na shurdhuan. Tashti ishte fare e qartë. Armiku pandehte se ne ishim një njësi tepër e madhe dhe nuk po i kursente predhat e veta. Të qëndronim në vend ishte vetëvrasje, prandaj nëpër atë rrëmujë, komanda jonë urdhëroi të tërhiqemi drejt perëndimit. Sa herë afrohej fishkëllima e mprehtë e predhave, përplasesha në tokë, çohesha përsëri dhe përsëri vijojeja udhëtimin. Aty këtu takoja shokë por po ashtu nëpër tymin e gjyleve. Afër një burimi, toka ishte me haliçë të vegjël, dheu ishte i lagështë dhe pikërisht aty shkava e s'u mbajta dot më këmbë. Për djall gjithë pesha e trupit më ra mbi gjurin ku kisha plagën e mbyllur dhe u përmbysa pa ndjenja përtokë. Sa kohë qëndrova ashtu, nuk mund ta kuptoja. Kur ardha në vete, nga të gjitha anët ishte vendosur qetësia. Shenjë shoku nuk dukej kurrkundi, zhurmë gjermani gjithashtu dhe m'u desht të mendohem për gjendjen e vështirë në të cilën u ndodha. Nisa të zvarisem ngadale me duar e këmbë nëpër pyll gjersa m'u duk se rashë në një monopat, vjova pas tij dhe u gjenda mu në grykën e një guve prej shkëmbi. Dielli ish-

te ngritur lart dhe hetova vendin an'e mb'anë. Megjithëse guva ishte e thellë, vendi nuk më dukej i përshtatshëm. Fare pranë kalonte një rrugë e gjerë pylli, bile atje ishte një udhëkryqe, por unë, duke mos gjetur dot vend më të sigurtë, hyra në shpellë. Atje u çlodha dhe prita gjersa më kaloi dhembja e gjurit. Kur desha të dal, dëgjo-va zhurmë përjashta. Në udhën e gjerë ka-lonin kalorës, dhe ishte fare e qartë që mi-dis atyre që flisnin gjermanisht kishte edhe asish që flisnin shqip. U bëra pikë e vrei dhe u kuspullosa sa më shumë në fund të guvës; shtërngoja fort pushkën në dorë dhe isha i vendosur: në qoftë se atje do hynte armik e të më zbulonte, do ndizja luftën pa të dilte ku të dilte. Tashti e harrova dhëmbjen e gjurit e lodhjen dhe vetëm mbaja vesh e dëgjoja.


E shihja botën që thellë nga guva. Larg, kundrejt, dukej një copë sohishte e grem-çar nga të gjitha anët sipas formës që kishte goja e shpellës sime. Një zhuzhak uturoi nëpër hyrjen e spilesë dhe i xixë-lluan këtej krahët e tij të ndriçëm, jeshilë e gushëpëllumbi. U dëgjua zhurma e zhu-zhakut dhe pastaj ai diku qëndroi pas faqes së shpellës. Gurguleja përjashta në rrugë u

ndez më e fortë, u dëgjuan sharje, urdhëra në gjermanishte, kërcënime në shqipe, disa përplasje përtokë, disa kërcitje si të qëlluara kopani mbi dërrasa. Një e shtënë arme, hingëllima, rrëmujë e madhe... Dikush kaloi fare pranë shpellës, dikush shau në shqipe gjermanët, dikush pëshpëriti:

— A nuk i lemë kafshët dhe i thërresim vrapit?

Kureshtja po më gryente përbrenda dhe nxitova në gojë të shpellës duke mbajtur gati armën. U çova në majë të këmbëve dhe vështrova me njerin sy:

Në udhëkryqe, një pështjellim e ngatërresë. Ishin ndeshur dy karvane me gjermanë. Karvanet kishin një mori kafshësh të ngarkuara me materiale lufte. Pas çdo kafshe ishte një fshatar shqiptar i marrë angari nga armiku. Disa mushka kishin anuar barrën e tyre, qenglat u ishin këputur, fshatarë të kërrusur shkonin pas tyre. Pastaj zemra më gufoi papritur. Midis fshatarëve të marrë qiraxhinj kishte edhe djem të moshës sime. Krojta kokën me dorën e majtë dhe shtërngova pushkën më fort me të djathtën, pastaj krojta hundën, qafën, mjekrën. Koka zu më ziente. Nuk mund të mby-



llet djaloshi në një shpellë dhe të bëjë sehir duarkryq. Se domosdo, duke ndenjtur duarkryq, i vogli nuk ka sesi të mundë të madhin. Planin tim e vura në jetë me një herë. E fsheha pushkën në një qosh të guvës, atje struka edhe fishekët, gjerdhanin; mbajta veç dy bomba dore që i fsheha mirë në trupin tim, dhe... nëpër rrëmujën dolla midis fshatarëve që akoma po mundoheshin të ngarkojnë mushkat. Kurrkush nuk pati mëndjen të më shohë mua, askush nuk më vu re, askush nuk më pyeti. Ku ta dish, ndofta fshatarët e njërës kolonë më pandehën të kolonës tjetër! Nuk di përse ja qepa sytë një moshatari tim ezmer nga fytyra dhe me një gunëzë të dhirtë mbështjellë tura e varur krahqafë. Kur iu afrova, ky më vërejti me mosbesim e desh të më largohet. Unë iu ngjita pas. Në një farë vendi më foli:

— Ku e ke kafshën tënde?

— Atje te udhëkryqja m'u shemb në përrua e ngordhi në vend. Po të më pikasin gjermanët, me qitin ngatërresa. Po deshe ti, dilmë krah...

— Ashtu? Po sikur të na pikasin?

— S'ka si na pikasin, unë di të sillem me ta, pastaj kam dhe diçka të fshehtë...

Syt e ezmerit xixëlluan, ata më vështruan me ngulm, pastaj vështroi rreth e rrotull, më kapi për xhakete e më pëshpëriti:

— Veç hap sytë.

Vërejtja e tij ishte shenjë e parë e besëlidhjes sonë. — Po çfarë është ajo e fshehtë që zure në gojë?

— Po të jesh shok i besës, unë do ta ndaj me ty, do habitesh, por tashti nuk është as vendi as koha. Po emrin si e ke?

— Rexhep; po ti?

— Më quajnë Vasil dhe... këtu fillon e fshehta por, si të thashë...

Karvani kishte qëndruar. Ne ishim në mes të tij. Prapa kishim roje milicë italianë, pas italianëve roje gjermanësh. Italianët ishin dy kategori: një palë ushtarë në shërbim të gjermanit me pushkë në krah (pa automatikë), pala tjetër shërbëtorë që përdoreshin vetëm për punëra dhe urdhëra. Gjermanët tashti shihnin hartat, pastaj nisën të grinden midis tyre, nisën të bërtasin, të urdhërojnë. Nuk merrja vesh çfarë ngjiste. Ishte një rrëmujë në gjuhë të huaj, me britma të huaja, me grindje të huaj, me një të folur të ashpër ku zotëronin ca rrokje me ung e zung. Vërejtja mirë ngarkesat. Ki-

shin arka ngjyrë gri. Jashtë arkat kishin ca kryqe të thyer, disa kafka njeriu, brenda disa folera prej dërrase, ku qenë vendosur gjyle e sharapnela. Vijoi shtegtimi; papritur në rrugën tonë qëndroi një gomar e hapi këmbët, përmbi gomarin që një oficer gjerman me gjyzëlyke në sy dhe një shishe rakië në dorë. Oficeri desh të bëjë shaka nëpër malet tona të ashpra, desh të tallet, desh të kapardiset. Gomari mashkull pëlliste; pallmën e tij e rrëmbente jehona grykë më grykë. Gjermani zbardhte dhëmbët, tej qelqeve të gjyzëlykëve i shkonin lotët prej haresë. . . pastaj këndonte «Lili Marlen». . . Ordinanca e oficerit fugonte përpara dhe merrte fotografi zotninë e tij herë shaluar, herë anash, herë hipur mbi gomar së prapi, herë në vithet, kurse gomari i ngratë tundte me mërzi veshët e tij lopatë.

Dale, o gjerman, pa e sheh ti. . . po nuk t'i qita nëpër hundë këto kapadaillëket e tua!

— E, do ma thuash të fshehtë?

— Akoma nuk guxoj, o Rexhep. Ta them, por me një konditë.

— Folë se jam gati.

— A bëhemi vëllamë?

— Vëllamë?!

— Pse, nuk të pëlqen ty, vëllamëria
është një zakon i bukur shqiptar. Në fsha-
tin tonë s'ka djalë që mos jetë bërë vëllam
me shokët e vet.

— Mirë, po qysh?

— Shpojmë gishtat fare pak dhe pimë
nga një pikë gjaku të shoku-shokut.

Mora një halth dëllinje dhe shpuam
gishtat tregonjës dhe thithëm gjak te një-
ri-tjetri. Shija më ngjau si e palcës që ka
çapoku i thëllëzës: pastaj zumë dorë dhe
ramë në krahët e njëritjetrit.


Por edhe nuk ishim ndarë nga përqa-
fimi, kur dëgjuam një të qeshur me pote-
re, një gajasje të papërmbajtur... Qeshte
dhe argalisëj gjermani kapadai me gjyz-
lykë në sy. Duke zvarisur këtej ordinan-
cën e vet na bënte shenja me tregonjës
thërriste, çirrej e çante dërrasa në gjuhën
e vet. E kuptova menjëherë. Ai gjerman
zevzek e kokëviç kishte vëzhguar skenën
kur unë me Rexhepin u bëra vëllam.
Tashti kërkonte me ngulm ta përsërisnim
edhe një herë thithjen e pikave të gjakut.
Unë bëra sikur u turpërova. Rexhepi u
turpërua vërtet, por me gjermanin nuk
bëhej shaka. Ai kishte vendosur medoe-
mos të merrte fotografi. Mos ngul këmbë,

Rexhep, — i thashë vëllamit, — eja t'ja bëjmë qejfin. Ky kërkon të na poshtërojë, por do ta paguajë shtrenjt këtë, eja.

Gjermani kokëtul na mori fotografi tri herë. Unë desh pëlçisja nga marazi. Rexhepi kafshonte gishtat me dhëmbë, kurse oficerit as që i shkonte mëndja se kishte fotografuar skenën e besëlidhjes që do t'i hante kokën. «Ti hiqesh i zgjuar, zoti gjerman, po nuk ta pret mëndja përse unë dhe Rexhepi u bëmë vëllamë, dale pa e sheh».

Vijonte udhëtimi. Larg dëgjoheshin qitje armësh. Gjermanët ishin të shqetësuar, përgjonin anash me droje e frikë, kurse unë e dija se në atë zonë nuk kishte partizanë.

Tashti shihja me sy egërsinë e shkelësve të huaj. Na dollën përpara disa jonxha nën një vah përroi; jonxhat ishin të rrethuara me gjerdhe. Një oficer u dha urdhër italianëve dhe këta i përshkënditën gjerdhet fije fije, veç hunjët e tutje shufrat. Më tej u dukën disa lisnikë e mullare; gjermanët i qëlluan lisnikët me revolverë. Dhe kishin disa revolverë të posaçmë: sapo hynte plumbi i tyre diku, jepte zjarr. Kështu që nisën të ngrihen lart flakadanë. Armiqtë nuk kursenin asgjë: panë diku



një kope dhish dhe u kthyen mitrolozin, diku doli një fshatar dhe e qëlluan. Më në fund hymë në një katund. Ishte krejt i zbrazur. Njeri i gjallë nuk dukej. Kishte diçka të frikëshme e ishte një rast tepër i mallëngjyer të shihje atë goxha fshat të mbetur shkretë, asgjë e gjallë, as edhe një shpend, as edhe një kafshë, dyert ishin lënë hapur, rrugëve ishin lëshuar orendi e levenxe. Kuptohej qartë se banorët do kishin ikur me nxitim e në panik. Ja një çezmë me tre sulinarë prej tunxhi. Një sërë pezulesh rreth çezmës. Në gurët e çezmës që lëshuar një kopan, një kanistër me tesha të lagura, një fjongo mëndafshi në ngjyrë lila, një sapun i vogël. Në kamare që një shishe e mbushur me ujë e me fletë trëndafili. Përdhe një çantë me libra shkolle, një abetare, dy kuklla leckë me krah e këmbë prej druri, sy e buzë shenjuar me thëngjill. Atij mëngjesi, në atë çezmë do kishin qënë vajza, djem, nëna. Dikush, do kishte larë rroba; vajzat do kenë qënë duke larë faqet e duke krehur flokët, djali duke punuar kunjën në shishen me fletë trëndafili, që ta bënte livandë, dy vajza të vogla do kenë qënë duke lozur me kukllat e tyre kur... jeta e qetë e fshatit u çart për-

gjithnjë. Vjen gjermani me pishë në dorë!
Vajzat lanë kukllat, fjongon lila, djali la
shishen me fletët e trëndafilin, nëna la rro-
bat, kanistrën, sapunin... fshatit i ardhi
fundi... dhe fundin e fshatit e dëgjova vetë.
Diku krisi një revole, thanë se u gjend një
plak ulok në oborrin e vet dhe gjermanët e
vranë në vend. Edhe vetë hyra në një shtëpi
mbetur çelur. Isha me Rexhepin, pas na u
vu një italian. Shtrojat e shtëpisë i kishin
hequr të zotët, dukeshin vetëm dysheqet
prej linace me arna shajaku të zi, mbushur
me thekërishte, një palare varur në mur, ko-
çeku i bukës mbetur çelur, në 'të një poçe
me gjalpë, në tavan një hu me llukanikë,
në pezulin e dritares një kupë me hoshaf
kumbllë, në qoshkun e lindjes ikonat me
kandilin e ndezur. Italiani desh të merrte
hoshafin po sikur i vinte turp nga ne, pas-
taj pa ikonat dhe ra u fal para tyre. Por as
ikonat nuk e shpëtuan dot shtëpinë e varfër.
Patozi u drodh me gjithsejt, nga tavani i ljer
me llullaq ranë leskra gëlqereje, kandili u
shua. Tre gjermanë hynë atje, pas tyre edhe
oficeri me gjyzlykë në sy. Ata s'e bënë të
gjatë po, si të ishin në mallin e tyre, rrëm-
byen llukanikët dhe poçen me gjalpë; osha-
fet s'i begenisën fare, qëlluan me shkelme
dyshekët dhe na bërtitën:

— **A u s !**

Ne u bindëm. Brenda krisi revolveri. Shtëpia shpërtheu në flakë, si të ishte spicë pishe. Kur dollëm në oborr pashë se i tërë fshati qe kredhur në zjarr, tymi ngrihej lart si një re e zezë e stërmadhe, kurse flakët ishin të verdha. Këtu u ligështova, m'u drodh buza gati në të qarë, dënesat më mbytën në grykë. Por bash një egërsi e tillë më jepte kurajë të ve në jetë planin tim. E keqja ishte se me armë nuk mund të qëlloja mbi armikun. Në një rast të tillë, çfarëdo vepre që të kryeja, ose do më kapnin ose do detyroheshin të largohem. Mendohesha të dëmtoj armikun dhe ai mos më pikaste, mendoja t'ja shkoja ujët ndën rrogos, mendoja në mësimet e Stefanit: «I vogli e mund të madhin me trimëri, me zgjuarësi kur ka me vete të drejtën». Kur mendoja këto m'u qas përseri Rexhepi:

— Hë, si thua, nuk më tregove të fshehtën tënde.

Unë krova kurrizin e hundës dhe ngrita sytë nga qielli. Lart në kupë të tij po sillej me vërtik një shqiponjë.

— Po, shiko këtu, Rexhep, në qoftë se për çudi të shket një fjalë, në qoftë se për çudi gabon, ta dish, na varin të dyve...

Ai struku kokën më fort nga unë.

— Na varin?

— Po, po.

— Mirë, mirë, po, thuajmë...

— Ja se ta them (vështrova rretherrtull): unë, o Rexhep, nuk jam qiraxhi, unë jam partizan!

Ai hapi gojën sa një kamare; sytë e tij tregonin mosbesim. Unë i tregova me kujdes të dy bombat e dorës. Goja e tij u mbyll menjëherë dhe sytë i lëshuan xixa.

— Domethënë ti prandaj deshe të bëhemi vëllezër?

— Po, Xhep.

— Po a më qasin mua partizanët?

— Kur jam unë këtu, ç'do ti? Kam Stefanin unë...

— Ti e njeh atë komisarin e dëgjuar?

— Unë e kam shok të ngushtë, po si thua?

Sytë e Rexhepit xixëlluan edhe një herë, por këtë radhë m'u duk sikur xixëlluan nga një farë zilie.

— Ne jemi vëllezër, Vasil, jemi edhe shokë, por unë kam edhe një hall tjetër.

— Folë.

— Po të ikim këtej s'mund ta marr kalën tim me vete, dhe kali i duhet shtëpisë.

— Do ta ndreqim edhe atë. Tashti njihmë për komandant se jam partizan më i vjetër.

— Domethënë unë nëmërohem partizan i ri?

— Pa tjetër. Dëgjomë, bindu, eja pas meje, kjo është ajo që ne në mal i themi disiplinë, kuptove?

Vargu i gjermanëve që nisur, fshatarët me kuaj pas tyre, në midis tyre, roje pas nesh. Fshatin e lamë pas në tym e flakë. Tashti rruga kalonte nëpër gurë e shkëmbenj. Gjermani me gjyzlykë, duke përçapur llukanikë në gojë, rrinte kabardisur majë gomarit me këmbët në shkallët e samarit. Në një farë vendi gomari zu hidhte shkelma; gjermani u lëkund e ja ngjeshi kafshës me thembrën e çizmes në bark. Gomari ngriti veshët puliq e nxitoi t'ikë, por mua diç më shkrepri në kokë: përvoja ime prej djali fshatar, ditët e gjata kur kullosja kuajt, gomarët, mushkat...

Çlodhje në mes të rrugës. Me Rexhepin u ula në një shkëmb. Më dukej se koka ma bënte tink nga vapa. Diçka fola me vëllamin tim kokë më kokë, i shkela edhe syrin. An' e mb'anë kishim mushka, kuaj, gomarë, pastaj fshatarë, të gjithë me moshë të ka-

luar. Oficeri me syza mërzente më tej. Akoa nuk ishte çmallur me gomarin se po dilte në fotografi qafë më qafë me të. Iu afrova një pele të ngarkuar rëndë, i përkëdhela vithet, bishtin. Pela hapi këmbët e pasme. Unë i futa pëllëmbën ndër shalë e i mblo dha gjithë mizat e kalit që kishte aty. Pela dridhej nga kënaqësia duke hepu ar shpinën. Unë futa në xhep grush tin e mbushur me miza. Përsëri fishkëlluan bilbilët e kapterëve gjermanë. Nisi marshimi; larg dëgjohej lufta; oficeri ja shaloi gomarit, mua nisi zemra të më këcejë. Edhe një herë më tingëlloi në kokë zëri i Stefanit: «I vogli kundër të madhit. . .» Po sikur të më diktonin? Të më diktonin! Jo. S'ka luhatje, thashë; pse të mendohem si frikacak? A mund të kem frikë unë që sillem në prapavijat e armikut? A nuk pat thënë Thanasi se unë jam hekur i kulluar dhe i dorës së parë?

Iu afrova gomarit. Zverku i kuq i gjermanit gufonte me një rrudhë të trashë mbi jakë, revolveri përkiste mbi kocaqet; oficeri sodiste një ujvarë tutje nëpër përruan e mallit me gurë. Unë hapa grushtin në xhep. Mizat ikën menjëherë e iu turrën gomarit. Dhe



ta dini: zëti i gomarit, hasmi i gomarit, armiku i gomarit është miza e kalit!

Me një tërsëllëm të vrullshëm gomari këceu përpjetë, u hodh turavrap, pastaj, si i thumbuar nga grera e akrepë, u mblodh kuspull duke qëlluar me turinj barkun e vet. Gjermani i lemeritur u lëkund, u troshanis, anoi një herë këtej, një herë andej dhe u përplas shakull mbi thepat e gurëve; këmba e djathtë iu ngatërrua nëpër shkallën prej litari të samarit; gomari rendte dhe hiqte pas oficerin që gërhiste si derri kur i futin thikën në grykë, pastaj britma e gjermanit u kthye në një çirrje, rruga e skuq me gjak, gurmazi i tij lëshoi një gërthitje të fundit. Nuk mund të shihja çfarë ndodhte në grumbullin e armiqve, por pashë çiltazi kur disa syresh qitën kapelat në shenjë nderimi për shokun e tyre që kish shkuar për dhjamë qeni. Oficeri me syze kishte mbaruar, kurse tutje anës së një zabeli gomari akoma s'e kishte ndarë sherrin me mizat e kalit. Aty afër një qiraxhi plak i fliste shokut të vet: «populli thotë një fjalë, më mirë të biesh nga lisi se sa nga gomari; e ka hien të rëndë ky djall!»

Dhe «djalli» i piskuar nga mizat e kalit vraponte si cjamin e egër anës së zabelit.

Rexhepi ma shkeli syrin, por unë i pëshpërita mos ma përsëritë më atë shenjë. I fola ngadalë: — I vogli e mund të madhin, na ë mori të keqen katili i dreqit; desh të tallej me ne, po ja ku po ja çelin gropën, e bëri sheshin kodër. . .

Aksioni na dha kurajë të vijoje më tutje. Tani edhe Rexhepi u trimërua. Vërtet se faqet e tij zeshkane ishin zbehur pak, porse sytë i lëshonin xixa; kurse flokët e tij kaçurrel e të zes i qenë ngritur lart si drizë. Tashti duhej menduar për t'u larguar nga karvani me qiraxhinj, por një punë e tillë nuk ishte e lehtë. Prapa nesh kishte roje italianësh dhe gjermanësh. Nisa të fërkoj tëmthat dhe nofullat me pëllëmbën time. U këshillova me shokun tim vëllam dhe e gjetëm të udhës që ikjen tonë ta linim për atë natë. Po edhe nuk kishte rënë nata, bile nuk kishte përfunduar dielli, kur na urdhëruan të qëndrojmë. Një qiraxhi tregoi se përpara, në xhadenë e gjërë, ishte hedhur në erë një urë dhe nuk mund të kalohej aty.

— Po nuk mund të kalohet nëpër vah?
— pyeti dikush.

Qiraxhiu shkeli syrin dhe foli ngadalë:

— Ata «miqtë» (e kish fjalën për partizanët) e kanë prishur rrugën aq keq atje

te gryka, ku është ura sa nuk mund të kalojë as cjapi.

Na urdhëruan të shkarkojmë kafshët. Ne u bindëm. Na urdhëruan të grumbullohemi në një livadh atje pranë. Ashtu bëmë. Pastaj doli një ballist e bërtiti si tellall: — Urdhër nga komandanti gjerman: kush bën të kapërxejë hendeqet e livadhit e ha plumbin në ballë dhe shkon si qeni në vreshtë.

Ra nata. Koka zu më ziente nga mendimet e me një gjemb kullumbrie shpoja e kruaja dhëmbët njerin pas tjetrit. Rexhepi më rrinte në krah dhe fytyra e tij në errësirë më dukej më e zezë se sa ishte me të vërtetë. Afër nesh ishte hendeku i livadhit. Mendova që kur të thellohej nata, të mbulonim në ledh dy arka me bomba dore, disa bomba të tjera t'i futnim në xhepe dhe t'i thërrisnim vrapit; në qoftë se takonim roje, t'i qëllonim dhe të zhdukeshim në pyllin pranë.

Qetësia u vendos ane mb'anë. Ishte një qetësi e frikëshme, askush nuk pipëtinte, bile edhe kafshët nuk hingëllinin. Ndihej robëria këtu, ndihej qënëja e armikut. Sikur në një rast tjetër, te ky livadh, të ishin mbledhur njerëzit tanë, nën dritën e zjarreve do ziente kënga, do hidhej vallja, pleqtë

do tregonin historitë e tyre, të rinjtë do dëgjonin. Por atë mbrëmje atje në atë truall shqiptar, ndodhej armiku që përgjonte si egërsirë.

Isha kredhur në mendimet e mia kur dëgjova një zhurmë që më shkundi me gjithsejt. Në pyllin kundrejt rrapëlliu çapëlima e një dege. Pastaj qetësi. Heshtje. E shpova Rexhepin në ijet. — Nuk fle jo, — ma ktheu ai. — Unë e di që ti s'fle, o vëllami im, por rri gati. — E ke fjalën për atë zhurmën prej druri? — Po, po.

Nuk kaluan as tri minuta kur errësira e zezë e natës nisi të qëndiset nga disa xixa të frikëshme, pastaj u dëgjuan zhurmat e bataveve. Partizanët sulmuan grykën e xhadesë nga të gjitha anët. Rexhepi u struk pas ledhit, ashtu vepruan edhe të tjerët qiraxhinj, kurse unë thujse nuk e prisha fare terezinë. Që të sulmonin partizanët kështu papritur e më tym, ishte punë që s'bëhej. Medoemos ata kishin gjurmuar me nge karvanin tonë, e dinin që te livadhi ishin fshatarët qiraxhinj, e dinin se trupat e armikut ishin shtrirë më lart pas xhadesë. Pastaj edhe ajo ura e prishur, edhe ajo rruga e vithisur, qenë gatitur me kohë. Këtu ishte gracka, dhokani. Fshatarët qira-

xhinj nisën të bërtasin, të ulërinë, të kërkajnë ndihmë:

— Amani oreee... jemi fshatarë, ore... qiraxhinj, ore...

Një italian ardhi e u struk në ledhin tonë. Pushkën e mbante ndër shalë, e dridhej sikur e kishte zënë ilet. Unë kapa për kondaku pushkën e tij dhe e hoqa pikërisht në castin kur zjente lufta me të madhe. Italiani nuk bëri as gëk. Vetë u largova prej tij. Rexhepi më shtërgonte pas palltoje e vinte pas. U shtritëm më tutje hendekut. Lufta ndizej më fort. Një hie po afrohej këtej diku pas shelgjeve. Si guxonte vallë të ecte aq serbes ai njeri që afrohej? Po ç'ishte vallë, qiraxhi apo gjerman? Pastaj dallova se i panjohuri kishte një armë në dorë. Mos ishte partizan? Krova me thonj tëmthin tim të djathtë; kur ecën një shqiptar ka një të ecur të tijën, i tund supet një herë këtej një herë andej, kurse gjermani ecën ndryshe, gati me një hap ushtarak. Pra, o burrë, bjeri. Ja këputa një koqe plumbi duke marrë shenjë kokën e tij. E kush merrte vesh aty se shkrehej një pushkë më shumë në gjith atë rrëmujë qitjesh! Unë prisja që i godituri të shtrihej barkazi, por fare papritur ai hapi krahët anash si dordolec arash, dhe u përplas mbi

shpinë duke çjerrë gurmazin e vet. U lëshova përmbi të. Dora më preku në follën e kollanit të tij prej lëkure. Pra ishte gjerman. Pranë tij shtrihej automatiku. Ja shkulla karikatorët nga brezi, i dhashë një të shtyrë, pastaj një të sharë. Xhepi më rrinte pas i mbledhur kuspull.

— I vrarë është ai? — më pëshpëriti.

— Po ç'pandeh ti, theket pas yjve?

— Më ardhi si frikë.

— Ashtu të vjen se nuk je mësuar.

Rendëm më tutje. Ishim në anë të një përroi.

Lufta po bëhej më e rreptë pas xhadesë lart. Po, pa shiko! Zotërinjtë gjermanë qenkan të zgjuar! E panë pisk përtpjetë dhe po zbrisnin andej nga fshatarët. Edhe ata e kishin kuptuar se partizanët nuk qëllonin te livadhi me qiraxhinj. Ata bukuroshë nuk e dinin se atje në atë qoshe përroi ishte një luftëtar që nuk përtonte t'ua mbushte kokat me barut. Përfundi përroit zunë e dalloheshin ca si derra të bardhë që zvariseshin tëhu. — Hë, qenat! Pa shiko, qënkeshin veshur ndër brekë për gjumë të qetë ndër livadhet tona. Ata që u kallnin zjarr fshatra-ve, ata që na vrisnin, që na rrëmbenin... na...



Nga gryka e automatikut tim del një st
hinkë prej flake, plumbat domosdo nuk
duken fare, por puna e tyre njihet menjë-
herë. «Derrat» në përrua zunë të këcejnë
si peshq në të thatë, ulërinë, kthehen pra-
pësht, përmbysen. Por Rexhepi nuk di të
luftojë. Është çuar më këmbë dhe vërvit
bomba italiane. M'u desh ta kap për xha-
kete e ta bëj të përplasat barkazi. Në atë
çast, u dëgjua pas nesh zhurma metalike
që lëshojnë këmbëzat e mitrolozit tek çel-
len. Më shkuan të ngjethura gjer në majat
e gishtave. Ktheva kryet. Fare pranë meje,
bri meje, pas meje, vijnë e shtrihen tre
gjermanë me mitrolozë. Por lufta është e
çuditëshme, e egër dhe e ethëshme. Sytë
sikur të lidhen, nuk di çka bën, nuk di ku
je dhe sidomos natën kur të mësyjnë në
befasi, kur të fishkëllon plumbi pas veshi,
kur je në tokë të huaj, ndërsa je shtritur e
fle. Tre gjermanët nuk më pandehën se isha
armik i tyre, më pandehën për shok të tyre;
as ua priste mëndja ndryshe, megjithëse
panë qartë flakën e automatikut tim që
villte zjarr. Mirë thotë populli një fjalë:
«Nuk sheh syri por sheh mëndja». Dhe mën-
dja e gjermanit asaj nate u bë dhallë e bozë.
Unë i pashë surratet e gjermanëve, pllakat

prej metali që mbanin në gjoks, bile njëri më foli:

— Kamerad! (kështu i thërrisnin shokët).

Tashti, sot, pas kaqe vjetësh, ju nuno-sem, ju rrëfhem. Kur i pashë ata tre goxha burra si Goliadhë, për një çast e humba toruan. Por unë asaj kohe isha zjarr e barut, mëndja ime qe e shpejtë si uji i gjallë, si engjervi... Në çast më dollën para syve të mëndjes Stefani im, mësonjësi im, zëri i tij, prazhda e Davidit, surrati i Goliadhit, thirrjet e shokëve, fshati që digjej, plaku që vritej dhe, mbi të gjitha, zemra më llokoçiste zjarr e flakë në krahëror! I vogli kundër të madhit! Automati-ku s'kishte krehër të mbushur; rezerva qe zbrazur. Koha s'priste, një grimë, një çast, një dyshim i vogël dhe më fluturonin trutë në përdua. Rexhepi e humbi toruan, por unë s'mund të humbisja kokën. Ja rrëmbeva bombat vëllamit tim, një, dy, tri, katër dhe ua hoqa lapëzat me dhëmbë. Sa shpejt ua hoqa! Harrova t'i pështyj, më mbetën në gojë. Sulm! Sikur nuk dëgjova zhurmat e plasjeve, veshi nuk më zu thirrje, as ulërima. Pashë vetëm flakë. Toka u drodh, një grusht dheu si bukëvale m'u derdh në zverk. Ç'bëhej kodrave, pas xhadesë, nëpër pyll as

kuptoja fare. E tërë qënëja ime ishte përqëndruar aty katër hapa më tej. Dhe kur ngrita kryet një çast, pashë një formë të ngatërruar në qëndrim të çuditshëm. Të tre gjermanët kishin mbaruar, kurse këmbët dhe krahët e tyre, të grirë apo të krasitur, qenë kapërthyer midis tyre në një mënyrë që është e pamundur ta përshkruaj.

Pastaj në livadh u bë një pështjellim e rrëmuje sa nuk e merrte vesh i pari të dytin. Plani i partizanëve ishte i qartë: të rrëmbenin plaçkën e luftës. I pashë partizanët që u vërsulën nëpër livadh! Urdhëri i shokëve u vu në jetë me një herë:

— O burranj kush të mundet më shumë, ngarkoni në shpinë arkat me bomba, arkat me pushkë, arkat me gjyle dhe hë, përpjetë malit!

— Po mushkat tona, kuajt tanë?

— Mushkat? Kuajt? Po a nuk i shihni që ata krisën e ikën të tmeruar nëpër pyjet? Nesër, më nge, i gjejmë...

* * *

Për fat të keq, njësia, që sulmoi kampin e gjermanëve, nuk ishte batalioni im. Kur u thashë disa luftëtarve se isha partizan, as-

njëri nuk më besoi. Rexhepi betohej e bërtiste për çka i kishin parë sytë në luftën e natës së mëparëshme, po kurrkush nuk i vuri veshin. Veç një korier djalosh më doli krah: Ai, duke vënë dorën mbi supin e tij e duke m'i ngulur sytë në fytyrë, tha:

— Bëj be, se shoku këtu është pioneri partizan i komisar Stefanit!

Më ngarkuan një kalë me armë ashtu si më takonte, më rrahnë supet, më uruan, më përçafuan dhe unë bashkë me vëllamin tim Rexhepin, u nisa për në batalionin tonë.

Njësinë time e takuam pas disa ditësh. Kur i tregonte Rexhepi Stefanit ngjarjet që kishin kaluar, komisar i hapte sytë e çuditej.

Por Rexhepi nuk mundi të vijë partizan, sepse, sapo u çlodhëm asaj nate, ai u sëmur, balli i digjte si prush. Stefani u kujdes vetë për' të dhe e nisi për në shtëpi të shoqëruar nga një grup shokësh.

* * *

Për rastin që do tregoj tashti, mbaj mënd se ishte një ditë e nxehtë gushti. Toka qe tharë e bërë pluhur. Njëpër arat me stërnishta, dheu ishte çarë thela-thela. Ishim shtritur në një arë të tillë e unë, i lodhur

dhe i djersitur nga udhëtimi i gjatë, kisha futur kokën pas një dëllinje, si ndonjë kone kur e ze vapa. Merrja frymë shpejt, shumë shpejt; qiellzën e kisha si me rëzhdë e buzët si të shkumbosura, sytë i mbaja tre katër gishta mbi tokë e atje po shihja një «kolonë» milingonash që nxitonin në punë të tyre. Afroheshin te një e çarë toke dhe ktheheshin prapësht, sepse nuk e kapërxejnë dot. Ato takonin njera tjetrën, duke përpjekur ca si brirë që kanë në kokë, e përsëri e përsëri vinin rrotull. Në një çast s'mund t'u besoja syve të mi: milingonat tërhoqën pas një fije kashte, e zvarisen më këtej, gjersa fija u vendos si një farë ure përmbi fijen e kashtës. Çudi, mendova, edhe këto insekte kaq të vogla punojnë e përpiqen dhe në nevojë ngrejnë edhe urë për të kaluar. Kështu edhe njerëzit, ne...

Ardhja e batalionit tonë te kjo arë kishite historin e vet. Ne nuk kishim ardhur këtu nga dëshira jonë. Të kapur në luftë befasisht me armikun, gjermanët na vunë përpara me topa e na ndoqën këmba këmbës. Sado që humbja është e hidhur, duhet ta them çiltazi se në atë betejë ne u tërhoqëm. Gjatë tërheqjes, iu afrova komisarit tonë dhe i thashë: Shoku Stefan, pa shiko, armiku na mposhti sot, pra, na mundi...

E megjithëse Stefani ishte i hidhëruar e cerevrarë nga humbja e pesë shokëve që ranë në luftë, më mbajti pranë, më dha zemër:

— Kjo që ngjau sot, o partizan, është pjesëzë e vogël e luftës së madhe. Dardha e ka bishtin prapa... Ne do fitojmë, kupton? I vogli e mund të madhin, i vogli trim dhe i drejtë, kupton?

Stefani bëri disa çape më tej, hyri ndën hien e një pishe të vetme që ndodhej aty, vari në degë maliherin, pastaj dylbinë, çantën e gjatë prej lëkure, fshiu djersët, ca me shami, ca me pëllëmbë dhe na foli:

— Batalioni do niset për luftim. Të plagosurit të qëndrojnë këtu, gjithashtu edhe të sëmurët, edhe ata shokë që janë tepër të lodhur. Midis këtyre të qëndrojnë edhe pioneri Vasil...

Nuk pata kohë të kundërshtoj, sepse komisari u nis në krye të kolonës dhe çdo kundërshtim, tashti, kqyrej si një shkelje disipline. Batalioni u nis për të qëlluar gjermanët që kishin hyrë në dy katunde, kurse ne ngelëm atje. Kaluan orët e zhegut të vapës. Disa fjetën me kokën kredhur ndën hien e dëllinjave; ashtu bëra edhe vetë. Në një farë kohe, mund të ishte ora nja

tre pas mesditës, ngrihet një nga mitralierët dhe kërkon të bëjë tekën e tij.

— Ore shokë, kam një fjalë për të thënë!

Unë e vështrova nëpër degëzat e një dëllinje e cila më shponte majën e hundës me halthet e saj të gjelbra. Mitralieri, një djalë tepër i gjatë, ishte tharë e bërë si cirua nga disa ethe të fshehura që e mundonin atyre ditëve. Si ishin këto «ethe të fshehura» njeri nuk mund ta kuptonte, porse partizani ishte ligur fort. Por edhe se ishte tretur shumë, zemra e tij dukej se ishte e fortë dhe vullneti i tij nuk kishte shok, sikurse u provua asaj dite. Ai vijoi të flasë:

— Shokët shkuan në luftë, ne mbetëm. Unë kam një plan timin. Kush ndjehet më mirë të më bëhet shok!

Njerëzit po shihnin mitralierin, pas-taj shoku-shokun, ngrinin supet, shpërveshnin buzët.

— Plan i im është ky: në fshatin Gozinë ndodhen gjermanët dhe ballistët. O burrani, t'u sulemi sipër!

Një ndërmarrje e tillë, pa urdhërin e komandës, ishte një shkelje disipline por, asaj kohe dhe atyre ditëve, delnin shpesh

ndër ne shokë kokëshkretë që ja shkrepnin partizance! Dhe hajde e mbaj vrullin e djemve, hajde e mbaj atë vrull që ushtëntonte maleve tona!

Disa minuta kishin kaluar dhe ne, dyzet e shtatë shpirt gjithë gjithë, nisëm marshimin. Por sepse ora kishte kaluar trenë, sepse rruga ishte e gjatë, sepse nuk na nxinte vendi, duhej nrituar. Rend të rendim e vrapo të vrapojmë! Mund të pyesë shumëkushi: si është e mundur që njerëz të lodhur e të sëmurë vrapojnë?! Besa besën nuk di si t'ua shpjegoj. Por kam dëshirë që për fjalët e mia të qit dëshmitarë ata farë djemsh që kisha shokë atyre kohëve, ndofta edhe malet tona që na panë dhe na dollën krah gjithënjë.

Pas ndonjë gjysmë ore, arritëm në një majë mali dhe atje dëgjuam qitje armësh që binin diku më nga lindja. Ishte e qartë se shokët qenë përfytur me armikun.

Kur u ngjitëm edhe më, na u ndeh përpara një farë kurore malesh që rrethonte katundin e Gozinës. Nd'anë të asaj kurore shquante një majë më e lartë nga të tjerat. Në një qoshe të saj xixëllonte diçka si xham, si metal i ndriçëm. Mitralieri ynë, që udhëhiqte çetën

tonë vullnetare, lajmëroi se kishim mbrijtur far fare afër vëndit për ku ishim nisur. Na ishte mbushur mëndja top se në majëzën ku xixëllonte ajo si copë teneqeje, kishte pa tjetër trupa të armikut. Majolja sundonte mbi të gjithë atë pellg dhe gjermani medoemos do kishte lënë rojet aty. Pra, së pari duhej të sulmonim pikën e lartër. U lëshuam në vrap drejt saj. Si thashë, vapa kishte ikur, por djersët na kullonin, sytë na ishin bërë si qelq, ankthi na mundonte, etja na digjte, por ne vendnim e vendnim pa pushim. Ishte një sulm tepër i frikshëm. Nga çasti në çast prisnim të na qëllonte armiku... Ahet, afër majoles, nisën e u bënë më të mëdhenj. xixëllima s'dukej më, u njohën buzët e një istikami, u dalluan pullat e bardha të drurëve; disa koçkorë druri dukeshin si tyta armësh (apo ishin tyta vërtet?). Nga çasti në çast prisnim të na vërsuleshin në fytyrë plumbat e armikut... por nuk ndodhi asgjë. Kur e kapëm majolen dhe nuk gjetëm atje njeri të gjallë, m'u duk për një çast se m'u shkrehën nervat dhe fare padashur u përgjunga e u shtrova shesh. Unë u shtrova, por «komandanti» ynë gjatosh e thatim me sytë e tij si

të shqipes gati përpinte pamjen përpara vetes. Zvarë zvarë u qasa edhe vetë ndër këmbët e tij. Aty afër dukej si burim. Edhe unë munda të shoh poshtë majoles: E kush kishte mëndje atje të sodiste panoramën e bukur që shtrihej përpara nesh? Kjo mund të bëhet sot me nge e me dëshirë, për gaz, për qejf, por atëhere nuk priste koha. Ndën atë kurorë malesn, poshtë, thellë, tatëpjetë, shtrihej një si ishull i vogël i rrethuar nga male të rrepta. Në mes të atij farë ishulli dukej katundi i Gorinës i kredhur edhe ai nëpër tumba me ahe e kumbulla të egëra. Aty këtu gjarpëronin monopate, rrugica pa krye ose pa fund, shtëpizat ndriçnin nga bardhësia e gëlqeres, por ishin açë larg sa dukeshin si guralecë. Njerëzit dukeshin si milingona, kafshët e mëdha si ndoca brumbuj. Era e freskisë së mbrëmjes përhapej an'e mb'anë dhe nga që ishim në lartësi tepër të madhe, nga një herë sikur më mbahej fryma. Por ndjehesha i lehtë, shumë i lehtë. Ngula kokën te burimi aty pranë, u nginja me ujë të ftohtë, laga llërët, njoma ballin, lava faqet dhe përsëri ngula buzët mbi ujërat që gufonin e gurgullonin nga të çarat e shkëm-

bit. Ndërkohë shokët përgjonin, matnin largësinë, kuvëndonin...

Fjalët e shokëve shqiptoheshin me ngadale dhe unë, i çlodhur nga ajri i pastërt i atyre majave, i nginjur nga ujët e kulluar, dëgjoja:

— Gjermani na pandeh se u zhdukëm dhe e ka fjetur mëndjen fare, as roje nuk ka vendosur.

— Ballit i ka marrë koka erë, pandeh se ne kemi vdekur dhe ka mbetur Shqipëria në dorë të tij.

— T'u vërsulemi me urra dhe t'i bëjmë fërtele!

Sikur t'i bënim hesapet me kalem në dorë, ndofta nuk do t'i hynim asaj valleje aqë të guximshme, por sikurse e dini, ne të gjithë ishim djem, dhe djalëria, or tungjatjeta, është si furtunë; mirë thonë pleqtë: i riu si veriu!

Kur më ardhi rradhë të marr dylbinë, vëreja se në fshat llogaritej të ishin nja treqind armiq, shumica ballistë e xhandarë, kurse nja pesëdhjetë syresh do të qenë gjermanë. Këta dalloheshin nëpër qelqet e dylbisë nga veshjet, nga automatikët krahëqafë ose nga mënyra sesi ecnin. Ishin grumbulluar të gjithë në një

kurriz kodre, disa ngulnin hunjë në tokë për të ngritur çadra, disa silleshin rreth kazanave të kuzinës, disa hapnin llogore, kurse një varg tjetër sillei nëpër shtëpitë e fshatit, domosdo jo për mirndajnatë, po për të rrëmbyer ndonjë zogëzë jariçe, ndonjë poçe gjalpë apo qyp me mjalte, ashtu si e kishin zakon ushtarët e ballit dhe trimat e Hitlerit.

Bëmë planin për sulm dhe u çuam të gjithë përpara. Mitralieri zuri vend në majole, kurse ne, e tërë çeta, zbritëm tatëpjetë nëpër driza, nëpër ferra, midis koriesh. Kur iu qasëm armikut, jo njëqind çape por vetëm dhjetë, iu vërsulëm në befasi. Komandanti ynë që nga majolja ua vërviti me mitroloz. Ne lëshuam thirrjet.

Në qoftë se gjermanët dhe ballistët do ta mblidhnin mëndjen shpejt, mund të mbaheshin sado pak, por ata i kapi paniku; u qëlluan kur nuk pandehnin dhe më s'u bënë për burra. Me sytë e mi pashe një oficer gjerman tek qëlloi me revolver një ushtar të tij që ikte, por ishte vonë. Kur derdhen ujërat tatëpjetë nuk përmbahen dot. Oficeri desh ta kthejë

prapësht rrotën e asaj lufte kur erdh dhe e kositi batareja që nga majolja. I dëgjo-va me veshët e mi armiqtë tek përpëli-teshin e ulërinin si çakaj:

— Obobo, partizanët!

— Nënëza ime, na kapën të gjallë!


Arrita te vendi ku oficeri gjerman shtrihej i vrarë përmbys. Një partizan i shkuli dokumentat nga xhepet. Prej një portofoli të zi dollën një tufë letrash, prej një kutize të vogël, një dekoratë. Një shok e rrëmbeu dekoratën dhe ngriti lart gishtin tregonjës:

— S'paska qënë dosido ky oficer! Pa shikoni, i dekoruar me një medalje të lar-të gjermane, me «Fletët e Lisit»!

Po nuk ishte koha për të pritur. Nga-renda përpjetë fshatit. Para më dolli një pirg plehu rrethuar me gardh. Sa bëj të kja-loj aty, nxjerr kokën që prapa një ballist; pushkën e mban në shenjë dhe më bërtet:

— Ndal, dorëzohu, duart lart se të shtri-va përtokë!

Më shkuan të ngjethura gjer në fund të këmbëve. Ku të më shtrinte ai! Unë u shtri-ta vetë! por pushkën nuk e hodha. As nuk e di qysh ja hoqa këmbëzën armës fare më hava dhe u përmbysa poshtë. Ballistin më



nuk e pashë; edhe atij i dhimte koka dhe u zhduk ku sytë këmbët.

Nga e djathta dukej një shtëpi e vjetër me dritare mbyllur me disa farë qepenesh prej dërrase të përzhitur nga dielli. Anash saj kalonte një rrugicë e ngushtë. Unë u turra pas saj. Por m'u desh të qëndroj. Një zë po më thërriste me ngulm:

— O partizan! O partizan!

Mezi zbulova njeriun që më thërriste. Ishte një çunak i vogël nja dhjetë vjeç, i strukur ndën një fron. Sa iu afrova, doli prej andej. Kishte një palë pantallona shajaku të grisura në gjunjë dhe të lidhura në bel me një prazhdë. Më foli ngadalë:

— Në qilarin tonë u fshehën një tufë me ballistë!

Me dorë më tregonte dritaret e vogla që ishin gati pas toke dhe me hekura kryq e tërthori.

Nuk e bëra të gjatë sepse, në luftë, një çats i kaluar kot, kushton shumë. Ngula grykën e automatikut tim në dritare dhe i hoqa këmbëzën. Nuk e mbajta tytën poshtë, porse lart, nuk desha t'i vras, desha t'i kap robër. Pas bataresë sime, britmat në qilar u kthyen në kuje të vërteta. Unë vetë thërrisja sikur jepja urdhëra:

— Qena, o qena! jepuni me të mire se u griva të gjithëve! Ti, Zeman, gati bombat atje; ti, Gjikë, mos ki frikë, ti, Thanas, mbush e zbras!

Kështu thërrisja dhe mundohesha që zëri im të dilte i trashë, i fortë dhe i ashpër si prej burri.

Nga gjithë anët armiku u vu në **ikje**. Pashë fshatarë me sopata e hunj nër duar, të tjerë me pushkë, të tjerë me qysqi që ndiqnin ballistët. Komandanti ynë sapo mbrijti ku isha vetë, desh të ikte më tej, por unë e qëndrova dhe të dy bashkë urdhëruam ballistët të dalin nga qilari. Veç të ishe e të shihje këta goxha burra tek dilnin si minjtë e përvëluar nga dhokani. Del një, dalin dy, dalin tre, pesë, dhjetë, trembëdhjetë! Disa ishin të gërvishtur, të grisur, pa kapela, me leshrat varur mbi surrat. U foli mitralieri:

— Hyyy more, s'kini turp të turpërohi! Turp bre, si nuk vini të mbyti në fund të dheut! Goxha burra me nga një **barrë mustaqe** e t'ju bëjë rob në pioner, një kalaman, hyyy jazëk bukën që hani!

Unë këceva përpjetë:

— Të lutem shumë ty, gjato, i ver fre asaj goje; s'jam kalama unë, si thua zotro-

te, more vesh apo jo? dhe këta (shenjova ballistët) të qofshin, mbaji se t'i kam falur, dhe të lutem shumë, tjetër herë, të mendohesh mirë pa të më thuash kalama. Se ti, mor t'u haptë dera, nuk e di parullën timë, ti nuk e di parullën e Stefanit, ti qënke bosh nga koka.

Gjatua po çaplonte sytë. Unë i kalova tregonjës in ndën hundë:

— E di ti apo jo? I vogli trim e mund të madhin! Hajde, vdekje fashizmit!

Dhe bash në atë çast më shkoi mëndja te mustaqet. Ah t'i kisha ato të flamosura atë kohë se për atë çast aq madhështor, kishte hie t'u bija mustaqeve një herë këtë, një herë andej, të ngrija hundën për-pjetë e sytë nga maja e qiellit!

Vonë, mesnatës që ardhi, u takuam me batalionin tonë. Stefani kish qenë gjithë inat. Dikush tha se kur kishte marrë vesh sulmin tonë, pa urdhër, që bërë si i egër; kur kish marrë vesh fitoren tonë, ish gëzuar vërtet, por Gjatun nuk e kish bërë të shkonte me kulaç për brezi. Disa thoshin se do ta qiste edhe në gjyq, disa thoshin se do t'ja falte. Por asaj nate as unë nuk guxova t'i delja përpara. Në mëngjes e gjeta te sofati i kishës së fshatit ku ishte i kërrusur e shkruante:

— Vdekje fashizmit, shoku komisar!

Përgjegjen ma dha nëpër hundë. — Mos u zemëro, Stefan, — i thashë, — dje kam bërë një zbulim të ri!

Maja e lapsit u thye mbi letrën e komisarit, ai më vështroi vëngër:

— Edhe ti ishe me anarshistët? (me prishësit e rregullit desh të thoshte).

— Shoku mësues, — ja ktheva unë që ta zbut, — kam bërë një zbulim të ri!

Ai ngriti kryet dhe më vështroi në sy:
— Folë!

— Ajo që ke thënë ti, se i vogli e mund të madhin, nuk është fjalë e plotë, diçka i mungon.

— Oj!

— Po, po. Kështu si them unë. Jo vetëm i vogli e mund të madhin por edhe i vogli i sëmurë dhe i drobitur, kur ka të drejtë, kur është frim dhe lufton në tokën e tij, për atdheun e tij, kur e ndihmon populli akoma edhe kalamajtë, atëhere ky i vogël, e mund të madhin!

U bëra dëshmitar i një skene që rrallë herë i takon njeriut ta shohë në jetë:

Një njeri i inatosur, nga një shkak fare i papritur shtërngohet t'ja japë gazit! Kështu ngjau edhe me komisarin

tim. Ai u vërsul mbi mua, më përqafoi, qeshi me të madhe, më shtërngoi akoma... Në një çast m'u duk se dënesej; dhe vërtet, kur i pashë sytë, i kishte me lot.

* * *

Më në fund edhe batalioni ynë u shkru në një brigadë. Dhe sa fat i madh për ne, sa gaz i madh për mua! Komisar i brigadës u caktua mësonjësi im Stefani. U mblo dhëm tetëqind e ca vullnetarë në një shpat mali, u ndanë të katër batalionet, u formuan shtabet, u mbajtën fjalime, dollëm në fotografi, kënduam këngë, hodhëm vallonë. Dhe bashkë me luftëtarët kishin ardhur atje njerëz nga krahinat rreth e qark. Aty ku mbaronte shpati e niste pylli, qenë lidhur varg mushka, kuaj, gomarë. Mbi samarët e kafshëve levenxe me lule, batani-je ushtarake, çerga, hejbe lariushe prej leshi, hejbe të zeza prej kozine, hejbe të vogla prej lëkure. Midis fshatarëve, një prift me mjekër të bardhë e raso të zezë, midis grave, një baba teqeje me një zverk të kuq e të ngjeshur, me çallmë bardh e jeshil, kurse në brez kishte lidhur një korrë prej porcelani sa një arrë. Dëgjoja kuvendime nga më të ndryshmet:

— Fishekë austrie nuk gjënden.

— Gjermani e përvëloi krejt fshatin tonë.

— Unë kam amanet një petanik me pulë për Hodon e Xharos.

— Unë kam një napë gjizë për Gjinen.

Dhe fare papandehur syt e mi takojnë një palë sy të ëmbël prej vajze, një palë sy të dashur, një palë sy të malluar fort. Kam përballë shoqen time Lenën. As e prisja as e shkoja ndër mënd që ajo të dilte partizane! Takimi ishte aq i papritur, bebëzat e syve tonë u ndeshën aq vrullshëm, aq me mall, aq me zjarr, sa u lëshuam në krahët e njëri-tjetrit. M'u duk sikur përqafova gjithë botën time, nënën, gurët e fshatit, sulinarët e çezmave, kopështet, rrugët, mullinjtë... Nuk kisha provuar kurrë një ndjenjë të atillë dhëmshurie dhe, i hutuar, i gëzuar, i lumtur, qaja me lot. Sa shumë më pat marrë malli! Edhe Lenës iu njomën sytë, pastaj iu drodh buza, lotët iu ronitën edhe asaj nëpër faqet e bardha.

Më kishte sjellë një torbë plot nga nëna, një palë çorape kozine m'i sillte ajo vetë. Duke përkëdhelur supin tim, më tha:

— Tashti mëma jote nuk shahet më, ajo të pret të kthehesh, vetëm falet dit e natë.

Unë nuk i përgjigjesha dot Lenës.

— Eja, — më grishi ajo — kam diçka për të të thënë, por më nj'anë.

Ajo u nis drejt pyllit. Unë i shkoja pas dhe shihja qafën e saj të bardhë ndën flokët e zes, shihja kurmin e saj të zhdërvjellët, ecjen krenare prej çapkëneje. Më pëlqente ta shihia ashtu sqimatave dhe të bukur, por krojta hundën me kurriz të dorës kur vura re se ajo qe rritur akoma më shumë...

Tashti ishim vetëm të dy në pyll. Ishim ndën hien e rëndë të aheve. Për rreth vinte erë e tokës së lagësht dhe e fletëve të ahut që po zverdeshin. Një qukapik rrihte fort thellë kories. T'ju them të drejtën edhe zemra ime kish të bënte me qellesat e qukapikut.

— Vëllaçko, më tha Lena, — duke më kapur pas dore, do të të kërkoj diçka.

— Folë, — ja prita unë me padurim.

— Të më gjesh një palë pantollona... kam ikur fshehur nga shtëpia ime...

— Mirë, unë kam një palë të tepërta, plaçkë lufte.

— Shiko sa mirë, edhe diçka.

— Hë...

— Të m'i shkruash gjithë këngët e reja partizane.



— Mirë, punë që bëhet. Tashti merr pantollonat.

I qita nga çanta e ja dhashë. Ajo m'u lut sërish:

— Tashti dil te ajo driza, bëj roje, sa të mbath pantollonat.

Bëra si më tha ajo dhe kur dolli andej, vura re se përmbi pantollonat ajo kishte edhe fustanin e vet.

— Të falem nderit, vëllaçko.

Mua më ardhi zor ta quaj motër.

Por asaj dite provova diçka të hidhur. Komisar Stefani më caktoi mua në batalionin e parë, kurse Lenën në të katërtin. Si zor ta takoja dendur shoqen time. Kjo nuk më erdhi hiç mirë dhe shkova te komisari.

— Kështu duhet, — ma ktheu ai, — më mirë kështu.

Nuk di përse ishte aq i çuditshëm vështrimi i Stefanit, sa unë nuk kisha kurajë ta pyesja përsëri.

* * *

Tashmë nuk ishim një batalion partizan, por një brigadë e tërë me tetëqind e ca vullnetarë dhe me komisar Stefanin. U larguam nga zona jonë dhe, luftë këtu, luftë atje, pusi këtu, pritë atje, ndeshje në xhade, përpjekje në mal, kaluam nja katër ditë rrugë nga vendi ku silleshim më den-

dur. Pas një udhëtimi të gjatë e të lodhshëm, më në fund zumë vend në trevën, ku u zhvillua beteja jonë e fundit.

Kur u çel dita pashë zabelet ku prehej e tërë brigada: male të rrepta pas shpine, male ca më t'egëra përpara, grykë ndëne, xhadeja si labirint poshtë, lumi si gjarpër dhe, për çudi, megjithëse vjeshtë, gjelbërimi i thellë si të ishte pranverë. Domosdo, fletët binin dhe ngjyrat e tyre kisha ëndje t'i shikoja, nuk nginjesha dot me atë bukuri që më mahniste. Të gjithë partizanët po hapnin llogore, maskoheshin me degë lisi, ngrinin avllira me shkëmbenj, vendosnin armët e rënda. Për karshi, nga një përrua i thellë dhe i gjatë sa vetë mali, rridhte një farë katarakti. Rrjedha ishte jo si shkumbë por si dëborë e bardhë. I fola Stefanit për ujvarën e ai ma ktheu:

— Kështu kullojnë malet tona, tashti, ujë të pastërt e valë të rreptë... pa afrohu këtu.

Unë iu qasa edhe më.

— Dale të bëjmë një hartim shkollë, nxënësi im, dëgjo: «Këto vende ku ndodhemi sot janë historike. Këtu ka luftuar Skënderbeu i Shqipërisë së vogël kundër Sulltanit të Turqisë së madhe...»

Mua më kishte kapërthyer vala e ima-

gjinatës sime dhe në kokë më buçisnin vjetët e lavdisë së Kastriotit. Stefani na foli gjatë e do të vazhdonte akoma (një grup partizanësh po dëgjonin edhe ata) por duhej të shkonte diku më tutje pas llogoreve dhe u çua.

E tërë brigada u nda dysh. Gjysma matanë xhadesë, gjysma më këtë anë, prisnim të kalonte gjermani dhe ta sulmonim. Vendi i pritës ishte gjetur si jo më mirë, armët qenë fshirë, bombat qenë pastruar, fisheqet qenë ndarë pesë e pesë, planet qenë bërë, mbetej tashti gjermani që të nxirrte kokën të futej në pritë, të shkapaderdhej aty poshtë si ajo spriha e përrallës dhe ne ta kopanistim ashtu si e kishte hak. Por gjermani s'dukej. Prit tashti e prit pastaj, kurrkush nuk pipëtinte. Ne kishim sajuar llogoret, i kishim maskuar me degë lisi, me kulpra e driza dhe rri të rrimë. Kur pret e pritja s'ka mbarim njeriu i gjallë domosdo ze e merret me sendet që e rrethojnë. Disa shihnin shqiponjat që silleshin mbi ne, të tjerë vërenin një vrimë diku te shkëmbi karshi tek hynte e dilte një dhelpër, dikush nëmëronte sqifterët që gjuanin brumbuj te një livadh, kurse roja akoma nuk po jepte shenjë për afrimin e armikut. Ni-

sa të humbas durimin edhe vetë; kaq vllat-
tarë thane i copëtova një për një, kaq lën-
de lisi i brejta me dhëmbë, kaq psherëtima
i preva përgjysmë, po gjermani s'dukej.
Ankthi më mundonte or' e çast dhe nuk ka
ndjenjë më të kobëshme se sa ankthi në
luftë. Në një farë kohe diçka nisi të lëv-
rijë pas mejë. Më ngjau sikur sikush zva-
risej pas shpine; ktheva kryet por nuk pa-
shë asgjë. Po përsëri zvarisje ndihej. Mën-
dova mos ishte ndonjë breshkë ugaresh a
ndonjë bretkosë livadhesh, më shkoi mën-
dja te ndonjë ujë malesh, por nuk i rashë
më të. Kur u dëgjua zvarisja më e qartë,
u ngrita përgjysmë dhe fare i habitur pa-
shë një goxha eshi, i cili, qetë qetë, qasej
nga unë. Prej shumë kohe s'kisha parë të
tillë, kështu që e përshëndeta me dëshirë
afrimin e mikut tim të ri. Eshi (apo iriqi,
si e quajnë disa), kishte xipa gri në ngjyrë
të bardhë, hunda e tij dukej pak, sytë ca
më pak, kurse koka aspak. Kur u afrua tek
unë dhe zgjata dorën drejt tij, shtaza u
tremb, u mblodh kuspull dhe xipat e tij të
mprehta si gjëlpëra kërseellitën sadopak nga
shpleksja. Më ishte e pamundur ta përkas
me dorë iriqin, kështu që e lashë në punën
e tij. M'u kujtua se kur ishim në fshat dhe

gjenim një esh të tillë, i mblidheshim rrotull, rrihnim një teneqe mbi kokën e tij dhe ai niste e loste një farë valleje duke këcyer. Ne këndonim, qeshnim e kërcenim pas valles së tij. Disa shokë që kisha pranë e vështruan eshin me qesëndi, disa deshën ta afrojnë, disa deshën të lozin me 'të, ndonjëri vuri gishtin tregonjës te buzët dhe qetësia u vendos përsëri, e plotë dhe e patrazuar gjatë gjithë llogores sonë. Eshi shkoi në punën e vet dhe ne nisëm përsëri me ankth e pa durim të psherëtimë, të rrahim tokën me pëllëmbë, të vështrojmë sipër nga vëndi i rojeve dhe përsëri e përsëri ndjeja një dridhmë të lehtë ndër gjymtyrët.

Herë pas here ndiheshin pëshpëritje, pastaj urdhëra për të mbajtur qetësinë, pastaj përsëri pëshpëritje, qeshje. Dikush kishte parë një ger në degët, dikush një kunadhe, tjetri një vidër pas lumit. Kur ktheva kryet të shoh eshin, ai nuk dukej më. Ishte larguar kushedi se nga. Në një farë kohe, afrohet tek unë një partizan dhe më grish në llogoren e tij. Megjithëse kjo ishte një shkelje disipline, unë u çova, sepse ato që më tha shoku, më bënë shumë kureshtar.

— Eja, — më tha ai, — eja të shikosh

një skenë nga lufta e pyllit; eshi yt po përleshet me një... eja, eja. Kalova nga llogorja ime i kërrusur domosdo, dredhova nga e majta, pastaj nga e djathta, bëra më tatëpjetë, qëndrova. Hodha sytë andej nga tregonte shoku me gisht duke ngulur vështrimin fort dhe pashë nja njëqind çape tutje, në një gropë me gurë, një ujë të zi dhe ndën putrat e tij, eshin që na kish vizituar pak më parë. Ishte me të vërtetë një kacafytje! Shoku më qortoi e më tërhoqi vërejtjen që mos bëja as zhurmën më të vogël. Po dëgjoi zhurmë ujku, — më tha ai, — ikën menjëherë; për dy gjëra dallohet kjo egërsirë e pyllit, ka veshë të hollë e sy të fortë, kurse nuhatje nuk ka fare.

Por ujku nuk dëgjonte mbase nga zhurma e ujërave të lumit, nuk shihte dot nga dëndësia e ferrave ku ishim ne, kështu që mundëm ta vërejmë skenën gjer në fund. Ujku e sillte rrotull eshin me thonjtë e këmbëve të tij; eshi rrotullohej; ujku zgjaste hundët nga iriqi, ky këcente, ujku prapsej si i tërbuar nëpër gropën e zu të ungronte me mllef, nisi të qëllojë me putër mbi eshin, pastaj nisi të angullijë, nisi të msyjë drejt formën rrumbullake të kafshës së vogël. Eshi nuk jepej kurrsesi, ai e shihte do-

mosdo se kish të bënte me një armik të madh e të fuqishëm, por nuk ngelej vetëm në mbrojtje; si duket, kur ndjente dihatjen e ujkut fare pranë. këcente dhe ja ngjesh-te ndër nofullat, ja përsheshte hundët.

Sa keq do më vinte sikur të qasej gjermani atë çast! Ujku bëri edhe një sulm të ri, duke mbajtur pas kokën e vet dhe u mundua ta kapë eshin me të dy këmbët e veta të para. Dhe vërtet eshi u suall në erë si lëmsh midis këmbëve të ujkut, por shtaza e madhe, si duket, u lebetit nga dhimbjet dhe e përplasi me një herë sikur iu dogjën putrat. U sul mbi të me shpresë se mos ishte çapluar masa e gjembave, po përsëri e gjeti shkëmb: Eshi këceu përsëri e ja ngjeshi hundëve. Dhe tashti ne vërnim fare aqik se surrati i ujkut pikonte e rridhte gjak. Të ishte një rast tjetër, një vend tjetër, ne do ta qëllonim ujkun dhe s'kishim për të parë këtu as ndeshje as betejë pylli. Por, sikurse e dini, ne prisnim gjermanin të vinte.

Ujku u tërhoq nga beteja me bisht ndër shalë, duke lëpirë, me gjuhën e tij të kuqe, nofullat e përgjakura, kurse mua m'u kujtua gjyshja ime kur më tregonte përralla për ujkun kokëtrashë, për ujkun kum-

tër që e fuste bishtin në ujë për të kapur cironj, m'u kujtua koha kur përsërisja vjershën «ujku pa fe, u afua në kope, e pa që s'kish qen, dhe hyri ndër dhen». Errësira po ikte, kurse unë isha kredhur pas kujtimeve të përrallave e m'u bë për një çast sikur ujku tashti shkoi të takojë zonjën dhelpër që t'i ankohet se «eshi korroveshi, më munda, më ngjeshi, dhe hundët m'i përsheshi».

Por skena që më tërhoqi, kishte me vete disa minuta jo të këndëshme. Duke ikur nga llogorja ime, unë shkela disiplinën. Dhe të shkelësh disiplinën në luftë është gjë e madhe. Dikush kishte njoftuar në shtab se kishin ndodhur lëvizje e zhurma në sektorin tonë. Komandantët qenë zemëruar dhe pa një pa dy më thërresin në shtab. Sikurse mora vesh, nuk e dinin se cili qe shkëlësi i rregullit, por sidoqoftë unë bëra me një herë nja treqind hapa praptazi, mbrijta në komandë. Në një farë guve të formuar nga një qark shkëmbinjsh, por pa mbulesë mbi krye, ishin radhitur anëtarët e shtabit ca më gjunjë, sa këmbëkryq e ca shtritur. Në krye të tyre, domosdo, Stefani. Ky sapo më pa, kafshoi buzën e poshtme. Mirëpo nuk bëhej shaka nga herë, se,

sikurse e dini, edhe herë tjetër e kisha cënuar disiplinën; s'mund të harrohej rasti i një majit, kur unë u bëra shkak të gjëmon-të pylli nga qitjet partizane dhe për qejf... kot së koti.

— Ç'janë këto gjëra që bën, Vasil, — ma priti Stefani, — ti tashmë nuk je i vogël... nuk ke turp, turp?...

Më ardhën rrotull gurët e guvës, po e mblodha menjëherë.

— Shoku mësues, — ja ktheva, — domethënë, shoku komisar Stefani, kam parë diçka të rëndësishme, dhe ja, prandaj e shkela, ja...

— Ti kërkon gjithnjë me «diçka të rëndësishme» të na hedhësh hi syve. Ne nuk tallemi këtu, ne luftojmë! Nëqoftëse armiku na dikton...

— Keni të drejtë, shokë, së pari duhet ta dini se unë shkova aq ngadale nga llogorja ime sa as syri e as veshi i ujkut nuk më zbuluan dot... Shoku komisar, kam bërë një zbulim të ri... ka raste kur edhe në botën e kafshëve, i vogli trim që ka të drejtën me vete, që është guximtar dhe sypatrembur, e mund të madhin... pashë diçka që ngjet si një përrallë. Luftonte atje poshtë te gropa me gurë një esh i vogël me një ujk të zi...

Tregimin tim dhe ndofta gjyqin tim e ndërpreu në çast një fishkëllimë e hollë që përshkoi guvën... Roja lajmëronte nga lart ardhjen e një autokolone gjermane. Vajta në çast në llogore. Por jo në timen. Shkova në një tjetër, atje ku u vendosën anëtarët e shtabit. Stefani më grishi për atje. Unë nuk e kundërshtova. Sa zumë vend dhe futëm tytat e armëve midis gurëve mbrojtës, hodha vështrimin poshtë:

Në xhadenë anës së lumit po hynte kollona gjermane. Kur e pashë gjithë atë horëdhj të ngarkuar mbi motorë, kur pashë gjithë ato tanke, gjithë ato autoblanda, gjithë ato armë të zeza, topa të rëndë, mortaja, sharapnela, t'ju them të drejtën, nuk më mbeti gjak në hundë. Por askush nuk qëllonte. Plani ishte hartuar me kohë. Sytë i mbaja andej dhe dëgjoja fjalët e Stefanit që u fliste shokëve të vet:

— Fuqia armike është e madhe, besoj të jenë afro 5000 vetë, por ne do t'i bluajmë këtu...

Një shprehje e tillë ma vuri trurin në lëvizje: Stefani tha: do t'i bluajmë. Po si, me se? Ndofta Stefani e kish fjalën për ata shkëmbenjtë e mëdhenj që kishim rrotull; a nuk ishin ata shkëmbenj shekullore si dhë-

mbë? Pra dhëmbët e maleve tona do t'i bluanin hordhitë e gjermanit! Bukuri. Ja fjalë të thëna me mënd; për besë Stefani e paskish fare mirë. Do t'i bluanim, do t'i zbinim. Dale dale, sikur më foli dikush në vesh, mos e shit lëkurën e ariut...

Lëkurën e ariut, or shok, unë s'e shes, por ja ariu tek është, ariu ka ardhur si shkelës dhe hajdut në vendin tonë, ka hyrë në pritën tonë, ndodhet ndën armët tona, ndën dhëmbët e shkëmbinjtë tonë dhe...

Plasën minat tona në xhadenë përpara. U dukën tutje në qiell disa forma të ngatërruara hekurishtesh. Autokolona e tërë u ndal. Disa makina u përplasën, disa hynë në hendek, të tjera u përmbysën dhe e zunë rrugën. Britma e llahtarëshme e luftës lëkundti me gjithsejt grykat dhe malet an'e mb'anë. Gjermanët këcejnë nga karoceritë, përplasen ndër ledhe, në xhade, pas gurëve të kilometrazhit, brenda në vahun e lumit, dynden pas ferrash, prapa shelgjesh, disa shtriheshin në mes të rrugës, të tjerë shtërngojnë me dorë gjymtyrët e veta, njeri kap këmbën, tjetri gjurin, njeri lëkundet e përmbysset, një tjetër bërtet...

Më në fund edhe pushka ime u nxeh aq fort sa nuk i çelej më llozi. Dhe nisën qit-

jet të rrallohen. Tashti, sipas urdhërave që dëgjoja, qëllonin vetëm shenjuesit tanë më të zotë, ata të cilëve nuk u shkonte plumbi kot. Pastaj një urdhër tjetër: Mitrolozin e flakës!

Unë akoma nuk e dija se ç'ishte ky mitroloz kur na e sollën pranë. Hë, hë, pastaj e njoha. Ky mitroloz kish qënë sjellë nga gjermani për një punë të posaçme. Me këtë mitroloz të rëndë, të shëmtuar dhe me një tytë tepër të gjatë, gjermanët u kallnin zjarr fshatrave tonë që nga larg. Ky mitroloz kish një veti të veçantë: atje ku mbrinte plumbi i tij, shpërthente zjarri. Bukuri, zotërinj gjermanë! Ju e sollët për ne, ja tashti provojeni në kurriz tuaj. Pas mitrolozit sollën arka me fishekë. Ishin disa fishekë të trashë e të gjatë me plumbat të lyer me të zi. Krizma e thatë e armës së gjatë të duket si një kollitje përbindshi. Dhe shenjuesi nuk qëllon dosido. Në xhade zu të merrnin zjarr kamionat e gjermanit. Por tashmë kishte mjeshtër ndër ne që nuk qëllonin kuturu. Qitjet bëheshin mbi kamionat me shumë rrota, sepse bash ndër ata farë kamionash gjermani mbante municione dhe bomba.

Pas pak gjermanët e mblodhën veten.

nisën të organizohen dhe pastaj filloi zjarri i tyre kundër nesh. Plumbat e armikut u dëndësuan, fishkëllimat e tyre e grisnin erën me egërsi. Gjermanët nuk mund të përdornin topat, sepse ishim fare pranë kështu që e gjetën me vend të sulmojnë. Dhe, kuptohet fare lehtë, për të arritur deri te llogoret tona, ata duhej të ngjiteshin nëpër disa rrëpira thikë përpjetë kështu që jo me plumba, por edhe me gurë mund t'i vrisje fare lehtë. Në kohën kur nuk e prisnim, grykat e maleve përqark ushëtuan nga një zhurmë e rëndë motorash, pastaj u duk lart një aeroplan gjerman, i zi si katrani. Aeroplani u ul mu poshtë, desh të na bombardojë, desh të na mitralojë por nuk mundej, së pari sepse grykat aty ishin si labirinte, me kthesa, rrëpira, pastaj ne nuk ishim më shumë se njëqind çape nga gjermanët. Aeroplani bëri disa rrotullime të rrezikshme, fluturonte brinjazi, me një krah lart e me një tatëpjetë; poshtë lufta zjente, bataretë ulërinin dhe kur s'e prisja unë fare, aeroplani lëshoi një zhurmë si rënkim, nga bishti i tij doli një fjollë tymi, u rrëkëllye si i pirë në ajër dhe... e humba nga sytë. Toka u drodh me të madhe, pastaj një zhurmë e frikëshme ardhi që tutje

nga mali prapa nesh. Aeroplani qe qëlluar nga bataretë e shokëve tanë, dhe u përplas e vate përgjithnjë. Një mbarim i tillë, domosdo, i dëshpëroi gjermanët, kurse nga llogorja në llogore valonte lajmi i madh: aeroplanin e rrëzuam!

Gjermanët u vërsulën të dëshpëruar drejt llogoreve tona, qëllonin me automatike, me pushkë dhe me ato mitralozët e tmershëm «Shars», por që të afroheshin tek ne duhej të kacavireshin duar e këmbë nëpër rrëzime, nëpër thepa, nëpër rrënjë lisash, kurse ne i korrnim, i qëllonim, i godasnim. Nisi të afrohet mbrëmja. Këtë e kuptova nga flakët e kamionave që digjeshin. Ato në fillim ishin të verdha, ato të zakonshmet, dhe blu, — ato që delnin nga djegëja e benzinës, por dalengadale flakët u kuqën e u skuqën gjersa u bënë si gjak. Dhe zjarret e përgjakura, si një flakadan i madh e i shpërndarë nëpër gjatësinë gjarpëronjëse të xhadesë, lëpinin hekura, para-fango, motorë...

Kur ra nata e plotë, u vendos qetësia. Një armëpushim i pabiseduar. Gjermanëve u zuri sharra në gozhdë. Me doemos oficerët e tyre ishin kapur ngushtë, nuk dinin nga t'ja mbajnë, nuk u pinte ujë as shko-

lla, as përvoja, as trimëria. Në mëngjes nisën qitjet përsëri, tashti gjermanët kishin hapur llogore, kishin zgjeruar hendeqe por, që të delnin nga prita jonë, ishte e pamundur për ta. Kamionat e tyre nuk lëviznin dot, sepse gomat dhe motorët u ishin shpuar tej matanë. Por edhe pa nisur mirë luftimi, u pa një flamur i bardhë në radhët e armikut. Pandeha se armiku po dorëzohej, por nuk ishte ashtu. Gjermani nuk jepej lehtë. Pas flamurit të bardhë ecnin dy njerëz. Urdhër nga Stefani: lerini të vijnë, lerini, askush mos i prekë!

Të dy njerëzit me flamurin e bardhë kaluan vahun, u futën në pyll, ku takuan shokët tonë. Se kush u lidhi sytë pas rregullit dhe i sollën mu tekistikami, ku isha edhe vetë. Aty Stefani urdhëroi t'u heqin pecet nga sytë. Njoha menjëherë një oficer gjerman dhe një ballist. I pari, megjithëse i dërmuar, e mbante kokën lart dhe nuk desh të shohë njeri në sy. Kur dolli para Stefanit, ky i foli shkurt:

— Përse ke ardhur?

Ballisti na qenkish përktshnjës dhe këceu me një zell të tepëruar. M'u duk çudi kur pashë surratin e ballistit. Unë

gjithë shokët e tij i pandehja pleq të shtrembët dhe pa dhëmbë, kurse zotria aty nuk i kishte më shumë se dyzet vjetët, mbante një orë ari në dorë; duart i kish me qime e gjoksin me lesh.

— Zotërinj partizanë, na ka dërguar komanda jonë për marrëveshje.

— Ç'marrëveshje, kërkoni?

— Të ju lëmë gjysmat e armëve dhe të na lini të kalojmë. Ne do ikim, do largohemi nga Shqipëria.

— Të lëshoni të gjitha armët dhe të dorëzohi rob të gjithë, kapitullim pa kushte, ndryshe s'ka.

— Këtë s'mund ta pranojmë.

— Atëhere do lini edhe kokat.

* * *

Marrëveshja që kërkuan të bënin gjermanët nuk u arrit.

Tërë dita kaloi me luftime nga llogoret e sejcilës palë. Gjermanët prisnin t'u vinin ndihma, por si u muar vesh më vonë, nga të gjitha anët rrugët ishin zënë dhe ata e kishin humbur toruan. Natën e dytë, gjermanët që kishin mbetur gjallë, lanë kamionat, llogoret, armët e rën-

da, dhe, secili për hesap të vet, u shpërnda për t'i gjetur çare kokës. Nga gjithë ajo hordhi prej pesëmijë vetësh, mundën të shpëtojnë vetëm disa qindra, natën nëpër terr, duke ikur ku sytë këmbët, gjithnjë nën qitjet e partizanëve që nuk kishin lënë shteg pa kapur. ,

Dhe kur u gdhi dhe e kapëm kollonën e armikut, m'u mbush koka se egërsia e gjermanit kishte qënë më e madhe nga sa e pandehnim: Të gjithë kamionët ishin ngarkuar me plaçka të rrëmbyera nëpër fshatrat tona. Dhe si ishin rrëmbyer ato plaçka, ç'vrasje e presje ishin kryer bashkë me plaçkitjet, merrej me mënd fare mirë.

Në një shpat mali u mblodh e tërë brigada. Vërtet se fytyrat e shokëve ishin më të hequra nga uria, nga pagjumësia, sytë u ishin përskuqur nga flaka e barutit, po hareja dhe gëzimi i fitores as mund të përshkruhet dot.

Stefani kërkoi të flasë: Fjala e tij ishte një sihariq i madh. Unë e dëgjoja me qejf e më kujtohej dita e largët e një majit kur zbraza pushkën e bëra rrëmujën. Por, dale se Komisari po flet:

— Shokë, e tërë Shqipëria jonë, me

këto gryka, me këto brinja, çuka, me këto male të ashpëra, me këta njerëz trima, është vetë një llogore e madhe. Qindra e mijëra vjet me radhë ne jemi strukur në këtë llogore që na ka mbrojtur dhe e kemi mbrojtur. Stuhitë dhe shtërgatat kanë ardhur njera pas tjetrës. Mirëpo as llogorja nuk na tradhëtoi ne, as ne nuk e tradhëtuan llogoren. Armiqtë që kanë dërmuar kokën këtu, e dinë fare mirë; gjermani që ndofta nuk e dinte, e mësoi tashti. Dhe ky karvan që shkatërroam ne, shokë, ishte i fundmi karvan i gjermanit në Shqipërinë e jugut. Atdheu po çlirohet...

Unë nuk e prisha qetësinë, nuk zbraza armë. Unë që isha djegur nga qulli i fryja edhe kosit, por, tashti, rregullin e prishën të tjerë! E kush përmbahet në një çast të tillë! Zhgëdau! krisi një armë në shenjë feste si në dasmë. Të tjerët ja kthyen tej për tej. Fishekë i kapëm gjermanit sa të duash dhe bjeri e bot si në gosti, si në dasmë, kur del dhëndëri në oborr. Komandanti fishkëlloi me bilbil. Stefani bëri disa shenja, bërtiste, diçka thoshte, por askush nuk e dëgjoi sepse fytyrat e të gjithëve kishin marrë zjarr nga gëzimi!

Si u vendos qetësia, m'u shkrep të takoj shoqen time Lenën. Kalova nëpër rreshtat e batalionit tim, kapërxeva rreshtat e të dytit, të të tretit, mbrijta te batalioni i katërt. Në një qosh lëndine, ishte një grup partizanësh, mbledhur kë kë më kokë. Më tej Lena bisedonte dhe qeshte me disa shokë. Më ardhi inat dhe futa hundët te shokët që rrinin grumbull. Ata kishin kapur një radiodhënëse gjermane, me një antenë të hollë e të gjatë, që xixëllonte nga shkëlqimi i nikelit. Aparatin herë e çelnin, herë e mbyllnin. Ai lëshonte disa britma të ho!la piu... piu... fiu... fiu... luanin rrotullën, dëgjohej muzikë... Mua dikush më tërheqte pas palltos. Kur kthej kryet shoh shoqen time. Që të mbuloj flakën e mërisë që më kish marrë fytyra ime, vura pëllëmbët ndër faqet dhe nisa t'i fërkoj gjoja rastësisht.

— Vasil, ti je bërë ca i egër.

— Pse?

— Ku ta di unë e gjora, ti më sheh me inat.

— Unë?

— Po, po, ti.

— S'është e vërtetë.

— Atëhere je bërë krenar, të është

rritur mëndja, ndryshe s'ka si shpjegohet.

— As kjo nuk është e vërtetë, por një gjë mund ta them çiltazi, kur të shoh që ti flet e qesh me të tjerët s'më vjen hiç mirë, kurse mua, mua më shikon sikur jam i vogël.

— Dhe më i vogël je vërtet.

— Nga trupi ndofta. Po mos harro se ti ke pirë sisë te nëna ime, nga pjesa ime.

— Këtë e di, prandaj ne të dy mund të jemi veç motër e vëlla.

Vajza u qas tek unë e duke mbështjellë shpatullat e mia me dorën e saj të djathtë, më hoqi tej nëpër lëndinë. Unë vështrova me krenari nga shokët e saj që nuk po i ndanin sytë nga ne. Kur ktheva sytë nga ajo, vura re diçka mbi faqet e saja:

— Lena, ti ke ngrënë qershi. Ja si të njihen shenjat në faqe.

Ajo qeshi: — Qershi në vjeshtë! Jo, te lisat afër llogoreve tona kacavireshin pjergulla të gjata me rrush, unë kam akoma në çantë, na...

Guxova dhe e shikova në sy, në fytyrë. Sa shumë i qe nxirë fytyra Lenës bardhoshe. Duke ecur, Lena e kuptoi që unë nuk duroja të ishte ajo më e madhe, an-

daj, në monopatin ku kalonim ajo zbriti në shtratin e ullishtës e unë në ledh, dhe kështu unë dukesha edhe një pëllëmbë më i gjatë se ajo dhe e vështroja si nga lart.

— Hajde, vëllaçko, nëma dorën këtu, ne s'jemi të prishur, ne jemi si më parë dhe tashti s'na ka hie të mbajmë mëri.

Unë ja dhashë dorën, u mundova të nënëqesh, po përsëri buzët e mia sikur shtrembëroheshin nga inati dhe marazi.

Kur u ndashë prej saj, takova Stefanin. Nuk di përse u bëra llafazan dhe e pyeta i pari:

— Nga ishe, shok komisar? Unë desha të të takoj, po kur do nisemi?

Stefani kalonte gjuhën midis nofullave dhe faqeve të veta, pastaj fërkoj mjekrën e tij të parruar e ma pat:

— More shejtan, mos u merr shumë me vajza!

Unë u bëra flakë në fytyrë.

* * *

Nuk kaluan as dy javë dhe u shpërnda lajmi i madh:

«Atdheu u çlirua». Edhe gjermanët ua mbathën këmbëve të mundur.

Tashti isha rritur, po përsëri mustakët nuk më kishin dalë. Megjithkëtë ndjehesha tamam djalë. Isha veshur bukur me rroba prej oficeri gjerman të kapura në fushën e luftës, kisha revolver në brez, dylbi në gjoks e çantë lëkure në krah. Stefani më mbante gjithnjë pranë. Dhe ndodheshim në Durrës. Qyteti ishte në rrëmujë të madhe. Ngado shikoje të kalonin italianët e mbetur rrugëve, italianët e mundur. Disa këndonin, disa çirreshin, disa qanin, të tjerë qeshnin e talleshin.

Në portin e Durrësit rrëmuja ishte akoma më e madhe, një pështjellim i tërë.

— Eja, — më foli Stefani, — eja të shohësh fundin e fjalëve që të kam thënë. Eja të shohësh, si e mund i vogli të madhin, eja!

Një vapor i madh, i zi, i shtrembët, mu në molo. Kish një flamur italian me tri ngjyra që ishte njollosur si mos më keq nga tymi i zjarrit a i kohës, ku ta dish. Kish ca oxhaqe të shtrembët, një govatë të shëmtuar. Nëpër shkallët e tij nxitonin të hipnin mizëri njerëzish që shtynin, shanin, mallëkonin.

Para e pas nesh kishte plot shokë që bënin sehir si dhe ne. Midis tyre ishte

edhe shoqja ime Lena. Papritur dikush bërtiti:

— Ngeci vapori, nuk niset dot, zuri govata në një bllok çimentoje.

Pastaj u dëgjuan të tjerë:

— E ka fajin zbatica!

— E ka fajin gjermani që e hodhi portin në erë.

— Jo, jo. Fajin e kanë këta djaj që ardhën pa i ftuar dhe na dogjën vatanin.

— Prisni baticën!

— Jo, jo! O burrani, ta shtyjmë. Tri motobarka po e rimorkojnë nga bashi.

— Edhe ca mauna, edhe ca motoska-fë!

— O burrani, ta shtyjmë me manivela!

Një turmë italianësh të tjerë u derdhën të hipin në vapor duke kaluar nëpër traversa e trarë. Njëri syresh nuk u nxitua. M'u qas dhe më foli. E kuptova menjëherë, desh të më bënte qejfin:

— Zoti komisar!

— Çështë, more, — ja ktheva unë.

— Zoti komisar, kisha një valixhe të madhe me plaçka; ma mbajtën partizanët këtu në doganë.

— Ashtu?!

Vura dorën mbi buzë sikur të dredh mustaqet dhe ngrita kokën më lart:

— Ashtu? Po nuk më thua, kur ardhë prej Italie në Shqipëri kishe valixhe?

— Jo, nuk kisha, jo... kisha veç një çantë ushtarake. se më suallën ushtar këtej.


— Bukuri. Dhe këtej rrëmbeve e vodhe sa munde. Po dëgjo këtu, ne kemi një zakon shqiptar. Kur e kapim hajdutin, ja marrim torbën e vjedhur, se po t'ja lemë, atij i hapet oreksi e vjen të vjedhë përsëri. Hajde, mbushu, qërohu që këtej! dhe ta dish, po ardhë përsëri si hajdut e si shkelës në vendin tonë, unë jo vali-xhen që do të ta marr po edhe kokën do të ta pres.

Buçitën motobarkat dhe motos kafët, turma e partizanëve ushëtiu:

— O burrani, t'i shtyjmë, o burrani!

Të gjithë u turrëm pas hekurit të zi të vaporit. Stefani që i pari, pas tij qeshë vetë, pas meje ishte Lena me sytë e saj të bukur. Kaçurreli i saj rebel i kishte shkarë nga kapela e i varej mbi faqe. Shtynte sa mundëte më shumë, ishte ngjitur me mua.

Më në fund vapori i shëmtuar u shkul



me një gërvimë të egër. Ajo gërvimë më ngjau si rënkimi i një përbindëshi që jep shpirt. Pastaj gjëmoi një rropatje e egër brenda në ujërat e detit.

— Ejani, tha Stefani, e shihni si mbaroi kjo histori! Lufta ka qënë e ashpër por, më në fund, i vogli, i drejti, trimi e mundi të madhin!

Ne i kthyem shpinën vaporit që lëkundej si i dehur nëpër dallgët e detit dhe muarëm rrugën drejt tokës sonë.

FUND

35020

LEXONI KËTO LIBRA PER FËMIJE

Për fëmijët parashkollorë

A. Mamaqi	— Bubi i vogël	10 lekë
Sh. Musaraj	— Letër nga fqinji	10 »
Z. Sako	— Trëndafilat	15 »
Z. Cikuli	— Lepurushët higjenushët	10 »
S. Kaputikjan	— Unë, Aljosa dhe Aliu	10 »
V. Sutjejev	— Nën këpurdhë	10 »
Y. Jakovlev	— Republika vak • vak - vak	10 »
— —	— Grupi i vogël i cirkut të kafshëve	10 »
— —	— Miqtë u zëmëruan	10 »

Për fëmijët e shkollave fillore dhe tetëvjeçare

N. Erashëri	— Fjalët e qiririt	10 lekë
N.R. Prifti	— Cikua dhe Beni	15 »
R. Kipling	— Si u bë gamilja me gungë	10 »
P. Gamara	— Aventura e gjarpërit me pendë	20 »